



Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZGJEDHJET PËR KUVENDIN
25 QERSHOR 2017

Misioni i OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve
Raporti Përfundimtar



Varshavë
28 shtator 2017

Përmbajtja

I.	PËRMBLEDHJE	1
II.	HYRJE DHE FALENDERIME	3
III.	SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK	4
IV.	SISTEMI ZGJEDHOR DHE KUADRI LIGJOR	5
V.	ADMINISTRATA ZGJEDHORE	7
	A. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE	7
	B. KOMISIONET E NIVELEVE TË ULËTA	8
VI.	REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE	9
VII.	REGJISTRIMI I KANDIDATËVE	11
VIII.	FUSHATA ZGJEDHORE	12
IX.	FINANCIMI I FUSHATËS	15
X.	MEDIA	17
	A. MJEDISI I MEDIAS	17
	B. KUADRI LIGJOR	17
	C. GJETJET E MONITORIMIT TË MEDIAS	18
XI.	PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE	19
XII.	ANKIMET DHE APELIMET	20
XIII.	VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE	22
XIV.	DITA E ZGJEDHJEVE	22
	A. HAPJA DHE VOTIMI	23
	B. MBYLLJA DHE NUMËRIMI	24
	C. NXJERRJA DHE SHPALLJA E REZULTATEVE.....	25
XV.	REKOMANDIME	26
	A. REKOMANDIME PRIORITARE.....	26
	B. REKOMANDIME TË TJERA.....	27
	SHTOJCA I: REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË ZGJEDHJEVE	30
	SHTOJCA II: LISTA E VËZHguesve TË MISIONIT NDËRKOMBËTAR TË VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE	31
	RRETH OSBE/ODIHR-IT	38

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZGJEDHJET PËR KUVENDIN
25 qershor 2017

Raporti Përfundimtar i Misionit të OSBE/ODIHR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve¹

I. PËRMBLEDHJE

Me ftesën e qeverisë së Republikës së Shqipërisë, Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) dërgoi një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) për zgjedhjet për Kuvendin të datës 25 qershor 2017. Për ditën e zgjedhjeve, MVZ-së së OSBE/ODIHR-it iu bashkuan delegacione nga Asambleja Parlamentare e OSBE-së, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës dhe Parlamenti Evropian për të krijuar një Mision Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MNVZ). MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vlerësoi përputhshmërinë e procesit zgjedhor me angazhimet e OSBE-së, detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike si dhe me legjislacionin vendas.

Deklarata e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake nga MNVZ-ja në 26 qershor nxori përfundimin se zgjedhjet “u zhvilluan pas një marrëveshjeje politike midis kryetarëve të Partisë Socialiste (PS) dhe Partisë Demokratike (PD), e cila siguroi pjesëmarrjen e opozitës në zgjedhje. Garuesit zgjedhorë ishin në gjendje të bënin lirshëm fushatë dhe liritë themelore u respektuan. Zbatimi i marrëveshjes politike krijoi sfida për administrimin e zgjedhjeve dhe rezultoi në një zbatim selektiv dhe jo të njëtrajtshëm të ligjit. Politizimi i vazhdueshëm i organeve dhe institucioneve të lidhura me zgjedhjet, si dhe akuzat e përhapura gjerësisht për blerjen e votave dhe presionin ndaj zgjedhësve, e ulën besimin e publikut në procesin zgjedhor. Në një ditë zgjedhjesh përgjithësisht të rregullt, procedura të rëndësishme nuk u respektuan plotësisht në një numër të konsiderueshëm të qendrave të votimit të vëzhguara. Pati vonesa në numërim në shumë zona”.

Zgjedhjet u zhvilluan në kontekstin e një hendeku të gjatë dhe të thellë politik midis PS-së së koalicionit qeverisës dhe PD-së së opozitës, si edhe të një besimi të ulët të publikut në procesin zgjedhor. Si zhvillim pozitiv, në 18 maj u arrit një marrëveshje politike midis kryetarëve të PS-së dhe PD-së, e ndërmjetësuar nga ndërkombëtarët, e cila i dha fund një ngërçi tre mujor. Marrëveshja i dha mundësinë PD-së për të bërë emërimet në disa poste kyçe ministrore, përfshirë një Zëvendëskryeministër dhe drejtues të institucioneve të tjera, si dhe mundësoi ndryshimin e datës së zgjedhjeve nga 18 në 25 qershor.

Kuadri ligjor përbën një bazë të përshtatshme për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike, megjithëse shumë rekomandime të mëparshme të OSBE/ODIHR-it dhe të Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës nuk janë trajtuar ende, përfshirë nevojën për depolitizimin e aspekteve kyçe të administrimit të zgjedhjeve. Ndryshimet ligjore që pasuan marrëveshjen politike të 18 majit kishin për qëllim uljen e kostove të fushatës, forcimin e mbikëqyrjes së financimit të fushatës dhe rritjen e dënimeve për shkeljet zgjedhore. Ndonëse marrëveshja kontribuoi në një proces zgjedhor më përfshirës dhe një fushatë më pak të polarizuar, zbatimi i saj shpesh vuri në rrezik parimet themelore të shtetit të së drejtës. Miratimi i vonshëm i ndryshimeve ligjore dhe mungesa e konsultimeve domethënëse publike cenuan sigurinë juridike dhe ndikuan negativisht në administrimin e disa komponentëve zgjedhorë, në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe standardet e Këshillit të Evropës.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) veprroi në mënyrë transparente me seanca të rregullta publike. Pas marrëveshjes politike të 18 majit, KQZ-ja dhe administrata e saj u përballën me një sërë

¹ Versioni anglisht i këtij raporti është i vetmi dokument zyrtar. Një përkthim jozyrtar është i disponueshëm në gjuhën shqipe.

sfidash komplekse ligjore, institucionale, financiare dhe administrative. Pavarësisht nga këto, KQZ-ja i zbatoi detyrat kryesore të saj. Megjithatë, KQZ-ja nuk mori masa për të sqaruar mospërputhjet që solli legjislacioni i sapondryshuar dhe disa prej vendimeve të saj u mungoi baza ligjore. Ngritja e komisioneve të niveleve të ulëta përfundoi kohë pas afatit ligjor për shkak të propozimit me vonësë të komisionerëve nga ana e partive. Kjo gjë, së bashku me numrin e madh të zëvendësimeve, bëri që një pjesë e madhe e administratës zgjedhore të mos ishte e trajnuar siç duhet. Në tërësi, kjo e uli eficiencën e administratës zgjedhore.

Regjistrimi i zgjedhësve bëhet sipas sistemit pasiv. Kufizimet në regjistrimin e zgjedhësve që lidhen me moshën dhe paaftësinë mendore janë në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet ndërkombëtare. Shpallja e vonuar e listave përfundimtare të zgjedhësve dhe njoftimi në mënyrë jo konsistent i zgjedhësve, kufizuan verifikimin publik të listave të zgjedhësve. Bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it nuk ngritën çështje domethënëse lidhur me saktësinë e listave të zgjedhësve, me përjashtim të pengesave të hasura nga komuniteti Rom. Megjithatë, problemet e kahershme të të dhënave të shumëfishta dhe kodeve të pasakta të adresave në listat e zgjedhësve mbeten një shqetësim.

KQZ-ja regjistroi 15 parti politike brenda afatit ligjor dhe, pas marrëveshjes politike të 18 majit, u regjistruan tre parti të tjera opozitare. Në të njëjtën kohë, dy garuesve të tjerë të mundshëm iu refuzua regjistrimi për shkak të propozimeve të vonuara. Ndonëse përfshirës në një shkallë të gjerë, procesi i regjistrimit të kandidatëve u ndesh me zbatimin përzgjedhës dhe jo të njëjtë të ligjit dhe, në disa raste, u mbështet në marrëveshjen politike dhe jo në ligj.

Fushata ofroi alternativa të shumëllojshme politike. Liritë themelore të tubimit dhe të shprehjes u respektuan. U zhvillua një fushatë e konsiderueshme në të gjithë vendin, megjithëse përdorimi i posterave dhe flamujve të përmasave të mëdha ishte i kufizuar si pasojë e ndryshimeve të fundit ligjore. Fushata u karakterizua nga aludime të përhapura gjerësisht për blerjen e votave, shqetësime për shpërdorimin e burimeve shtetërore dhe presione ndaj zgjedhësve të lidhura me vendin e punës, të cilat e ulën më tej besimin e publikut.

Gratë ishin aktive, por të nënpërfaqësuar në fushatë. Disa prej aktiviteteve synuan në mënyrë të veçantë gratë zgjedhëse. Megjithatë, partitë më të mëdha politike nuk i respektuan gjithmonë kuotat gjinore në listat e tyre të kandidatëve dhe pati një mbulim të paktë mediatik të kandidateve gra. Ndonëse rreth 40 për qind e kandidateve ishin gra, ato morën vetëm 27.9 për qind të vendeve në Kuvendin e ri. Gratë ishin të nënpërfaqësuar edhe në administratën zgjedhore, përfshirë pozicionet vendimmarrëse.

Legjislacioni i ndryshuar kontribuoi në transparencën dhe llogaridhënien për financimin e fushatës, duke trajtuar pjesërisht disa rekomandime të mëparshme të OSBE/ODIHR-it dhe të Këshillit të Evropës. Masat e reja për uljen e kostove të fushatës u mirëpritën nga pjesa më e madhe e bashkëbiseduesve të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it. Megjithatë, miratimi i vonë i ndryshimeve la pak kohë për zbatimin e tyre të plotë. Rregullave të reja për fushatën u mungonte, herë pas here, konsistenca dhe qartësia. Transparenca e financimit të fushatës u zvogëlua nga mungesa e detyrimit të partive për t'i bërë publike të dhënat mbi financimin përpara ditës së zgjedhjeve.

Mediat i përcollën elektoratit një pasqyrim të gjerë të fushatës, duke u ofruar zgjedhësve një gamë të gjerë opinionesh politike. Megjithatë, mediat ofruan një qasje të kufizuar analitike. Garuesve në zgjedhje iu ofrua mundësia për të marrë pjesë në debate, por nuk u zhvillua asnjë debat mes kryetarëve të partive kryesore. Monitorimi i medias nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it tregoi se të gjitha kanalet televizive të monitoruara u fokusuan kryesisht në aktivitetet e tri partive më të mëdha. Transmetuesi publik e respektoi detyrimin ligjor për të siguruar në mënyrë proporcionale minutazh pa

pagesë për partitë. Mes KQZ-së, Bordit të Monitorimit të Medias dhe subjekteve mediatike u vendos një bashkëpunim pozitiv, edhe përsa i përket zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të medias.

Pakicave kombëtare iu dha përgjithësisht një mundësi e drejtë për të marrë pjesë në zgjedhje, qoftë si kandidatë ashtu edhe si zgjedhës, përfshirë në gjuhët amëtare. KQZ-ja prodhoi disa materiale për edukimin e zgjedhësve në gjuhët e pakicave. Disa bashkëbisedues të MNVZ-së ngritën shqetësime specifike rreth përpjekjeve për blerjen e votave në zonat me popullsi të madhe Rome dhe Egjiptiane.

Kodi Zgjedhor parashikon një procedurë për ankimin administrativ kundër vendimeve të komisioneve të niveleve të ulëta dhe apelim gjyqësor kundër vendimeve të KQZ-së. Megjithatë, përgjegjësia për shqyrtimin e ankesave për shkelje të rregullave të fushatës ishte e paqartë. Kufizimi i legjitimitetit për paraqitjen e apeliave kundër vendimeve të KQZ-së mund t'i lërë palët e prekura pa një mundësi zgjidhjeje ligjore. Një numër i vogël apeliave gjyqësore u bënë para ditës së zgjedhjeve pranë Kolegjit Zgjedhor. Të drejtat procedurale të palëve u respektuan dhe vendimet e Kolegjit ishin të arsyetuara, edhe pse jo gjithmonë në mënyrë konsistente. Asnjë vendim i KQZ-së nuk u apelua pas zgjedhjeve.

Ligji parashikon vëzhgim vendor dhe ndërkombëtar në të gjitha fazat e procesit zgjedhor, por, në ndryshim nga vëzhguesit e partive, nuk u njeh këtyre vëzhguesve të drejtën për të marrë kopje të tabelave të rezultateve të numërimit dhe atyre përmbledhëse. Si hap pozitiv, KQZ-ja i detyroi komisionet e niveleve të ulëta të afishonin publikisht rezultatet e votimit, duke shtuar kështu transparencën. Akreditimi i vëzhguesve ishte përfshirës.

Dita e zgjedhjeve u zhvillua më së shumti në mënyrë të rregullt, por u vërejtën parregullsi dhe mosveprime procedurale kyçe. Këto përfshinë procedura jokonsistente për verifikimin e shenjimit me bojë, raste të votimit për persona të tjerë dhe në grup dhe ndërhyrje të aktivistëve të paautorizuar të partive. U vërejtën shqetësime lidhur me kërcënime të mundshme nga grupe aktivistësh të partive brenda dhe rreth qendrave të votimit. Procesi i numërimit u vonua në shumë zona. Procedurat e numërimit nuk u respektuan gjithmonë dhe transparenca nuk u garantua gjithmonë. Pjesëmarrja në votime u raportua 46.8 për qind.

Ky raport ofron një numër rekomandimesh në mbështetje të përpjekjeve për t'i sjellë zgjedhjet në Shqipëri në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Rekomandimet prioritare kanë të bëjnë me një reformë zgjedhore përfshirëse dhe të zhvilluar në kohë, çështjen e vazhdueshme të blerjes së votës dhe shpërdorimit të burimeve shtetërore, depolitizimin e administratës zgjedhore, kufizimet e paarsyeshme të të drejtave të zgjedhësve, dekriminalizimin e shpifjes, të drejtat e mirëfillta të vëzhguesve dhe garancitë për të drejtën e një zgjedhjeje të lirë dhe të fshehtë. OSBE/ODIHR-i është i gatshëm t'i ndihmojë autoritetet për të përmirësuar procesin zgjedhor dhe për të trajtuar rekomandimet e përfshira në këtë raport dhe në raporte të mëparshme.

II. HYRJE DHE FALENDERIME

Në përgjigje të ftesës nga qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe mbështetur në rekomandimet e Misionit për Vlerësimin e Nevojave, zhvilluar prej datës 6 deri më 9 mars 2017, Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) ngriti një Mision për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MVZ) më 9 maj 2017. MVZ-ja u kryesua nga Ambasadori Peter Tejler dhe përbëhej nga një ekip bazë prej 15 ekspertësh të vendosur në Tiranë dhe 26 vëzhguesish afatgjatë të vendosur që nga data 19 maj në të gjithë vendin. MVZ-ja qëndroi në Shqipëri deri më 7 korrik 2017 për të ndjekur zhvillimet paszgjedhore.

Për ditën e zgjedhjeve, MVZ-së së OSBE/ODIHR-it iu bashkuan delegacione nga Asambleja Parlamentare e OSBE-së (OSCE PA), Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (PACE) dhe Parlamenti Evropian (PE) për të krijuar një Mision Ndërkombëtar për Vëzhgimin e Zgjedhjeve (MNVZ). Z. Roberto Battelli u emërua nga Kryetari i Radhës i OSBE-së si Koordinator i Posaçëm dhe drejtues i misionit vëzhgues afatshkurtër të OSBE-së. Znj. Marietta Tidei kryesoi delegacionin e OSCE PA-së. Z. Paolo Corsini kryesoi delegacionin e PACE-s. Z. Eduard Kukan kryesoi delegacionin e PE-së. Secili prej institucioneve të angazhuara në këtë MNVZ mbështeti Deklaratën e Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve 2005.² Gjithsej ishin 327 vëzhgues nga 43 shtete, përfshirë 255 vëzhgues afatshkurtër dhe afatgjatë nga OSBE/ODIHR-i, si dhe një delegacion me 34 anëtarë nga OSCE PA, një delegacion me 25 anëtarë nga PACE dhe një delegacion me 11 anëtarë nga PE. Procedurat e hapjes së votimit u ndoqën në 135 nga 5,362 qendrat e votimit dhe procesi i votimit u vëzhgua në 1,357 qendra votimi. Numërimi dhe nxjerrja e rezultateve u vëzhguan në 59 Vende të Numërimit të Votave dhe Komisionet Zonale të Administrimit të Zgjedhjeve.

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vlerësoi pajtueshmërinë e procesit zgjedhor me angazhimet e OSBE-së, detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike si dhe me legjislacionin vendas. Ky raport përfundimtar pason Deklaratën e Gjetjeve dhe Përfundimeve Paraprake, e cila u dha gjatë konferencës për shtyp të datës 26 qershor në Tiranë.³

OSBE/ODIHR-i dëshiron të falënderojë autoritetet për ftesën për të vëzhguar zgjedhjet, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme për ndihmesën dhe bashkëpunimin. Gjithashtu, shpreh vlerësimin për përfaqësuesit e partive politike, shoqërisë civile, medias, komunitetit ndërkombëtar dhe bashkëbiseduesve të tjerë për shprehjen e pikëpamjeve të tyre.

III. SFONDI DHE KONTEKSTI POLITIK

Shqipëria është republikë parlamentare, ku pushteti legjislativ ushtrohet nga Kuvendi njëdhomësh me 140 deputetë dhe pushteti ekzekutiv ushtrohet nga qeveria e drejtuar nga Kryeministri. Zgjedhjet parlamentare të 2013-ës sollën një qeveri të kryesuar nga Partia Socialiste (PS) dhe kalim pushteti nga qeveria e mëparshme drejtuar nga Partia Demokratike (PD).⁴ Që prej zgjedhjeve të fundit parlamentare, Kuvendi ka miratuar me unanimitet ndryshime kushtetuese për të nisur një reformë gjithëpërfshirëse në drejtësi dhe për të kaluar një ligj që ndalon mbajtjen e posteve publike nga persona me të shkuar kriminale. Gjithsesi, klima politike vazhdoi të karakterizohej nga mosbesimi i zgjatur mes PD-së dhe PS-së.

Në 5 dhjetor 2016, Presidenti i Republikës dekretoi zhvillimin e zgjedhjeve parlamentare në 18 qershor 2017. PD-ja nisi bojkotin ndaj Kuvendit më 7 shkurt, duke pretenduar se qeveria e drejtuar nga PS-ja po përgatiste një mashtrim zgjedhor në shkallë të gjerë dhe se, në kushtet aktuale, nuk mund të zhvilloheshin zgjedhje të besueshme. PD-ja dhe aleatët e saj deklaruan se nuk do të merrnin pjesë në zgjedhje në rast se nuk do të plotësoheshin disa kërkesa, përfshirë dorëheqjen e Kryeministrit, krijimin e një qeverie teknike dhe futjen e votimit elektronik. PS-ja i refuzoi këto kërkesa dhe pretendoi që PD-ja nuk dëshironte të merrte pjesë në zgjedhje për shkak të mungesës së mbështetjes popullore.

² Shih [Deklaratën e Parimeve për Vëzhgimin Ndërkombëtar të Zgjedhjeve](#)

³ Shih [të gjitha raportet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it për Shqipërinë](#).

⁴ Si rezultat i zgjedhjeve parlamentare të vitit 2013, "Aleanca për Shqipërinë Evropiane" mori 83 mandate, nga të cilat PS - 65, Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI) - 16, Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut (PBDNJ) - 1, Partia Kristian Demokratike (PKD) - 1. "Aleanca për Punë, Prosperitet dhe Integrim" mori 57 mandate, nga të cilat PD - 50, Partia Republikane (PR) - 3, Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) - 4.

Ndërsa ngërçi vazhdonte, partitë e opozitës nuk u regjistruan në zgjedhje brenda afatit ligjor të datës 9 prill.⁵ Pas skadimit të të gjitha afateve të regjistrimit dhe pas vendimit të KQZ-së për miratimin e përmbajtjes së fletës së votimit, më 13 maj u zhvillua në Tiranë një protestë e madhe e drejtuar nga PD-ja, ku u konfirmua thirrja e kësaj partie për pranimin e kushteve të saj në këmbim të pjesëmarrjes në zgjedhje.

Pas ndërmjetësimit intensiv nga ndërkombëtarët, ngërçi mori fund në 18 maj me arritjen e një marrëveshjeje politike mes kryetarëve të PD-së dhe PS-së.⁶ Marrëveshja siguroi pjesëmarrjen e PD-së dhe të aleatëve të saj në zgjedhje dhe përcaktoi që PD-ja do të merrte disa poste qeveritare kyçe, përfshirë Zëvendëskryeministrin, gjashtë ministra, Kryetarin e KQZ-së, drejtuesit e disa institucioneve shtetërore, dhe Avokatin e Popullit.⁷ Marrëveshja parashikoi gjithashtu shtyrjen e zgjedhjeve për në datën 25 qershor, si dhe zgjatjen e afateve për regjistrimin e partive dhe kandidatëve deri në 26 maj.

Megjithëse marrëveshja u mirëprit nga figura politike kyçe si dhe nga komuniteti ndërkombëtar, disa bashkëbisedues të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it ngritën shqetësime rreth efekteve të saj mbi aspekte ligjore të procesit zgjedhor dhe ndikimit mbi garues të tjerë përveç PD-së dhe PS-së.

IV. SISTEMI ZGJEDHOR DHE KUADRI LIGJOR

Të 140 deputetët e Kuvendit zgjidhen për një mandat katërvjeçar nëpërmjet një sistemi përfaqësimi proporcional me lista të mbyllura në 12 zona zgjedhore shumëmemërore që përkojnë me qarqet administrative.⁸ Partitë dhe koalicionet e partive që regjistrohen në zgjedhje duhet të paraqesin lista kandidatësh për të gjithë zonat.⁹ Partitë dhe koalicionet që e kalojnë pragun prej, përkatësisht, tre dhe pesë për qind të votave të hedhura në zonën përkatëse, përfitojnë nga shpërndarja e mandateve.¹⁰

Kuadri ligjor për zgjedhjet për Kuvendin përbëhet nga Kushtetuta e vitit 1998, Kodi Zgjedhor i vitit 2008 dhe akte të tjera ligjore.¹¹ Shqipëria është palë në instrumente ndërkombëtare dhe rajonale lidhur me mbajtjen e zgjedhjeve demokratike.¹² Pas zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015 u ngrit një Komision i Posaçëm Parlamentar, i bashkëkryesuar nga përfaqësues të PD-së dhe PS-së, për të hartuar ndryshime në Kodin Zgjedhor. Megjithatë, puna e Komisionit u bllokua shpesh dhe ai nuk arriti të finalizojë ndonjë projektligj. Sipas disa bashkëbiseduesve të MVZ-së së OSBE/ODIHR-

⁵ Partia Agrare Ambientaliste (PAA), e cila ishte pjesë e opozitës parlamentare, u regjistrua për të marrë pjesë por nuk depozitoi listat e kandidatëve.

⁶ Një tekst i marrëveshjes politike të 18 majit u publikua në faqet e internetit të PD-së dhe PS-së. Ai përfshin angazhimin për të vijuar procesin e reformës gjyqësore dhe zgjedhore, për të futur votimin elektronik në zgjedhjet e radhës dhe për të institucionalizuar dialogun mes dy drejtuesve të partive.

⁷ Parlamenti shkarkoi Avokatin e Popullit dhe emëroi një të ri më 22 maj, pa marrë parasysh procesin që parashikon ligji. Avokati i ri i Popullit e bëri betimin vetëm më 17 qershor, duke e lënë institucionin e të drejtave të njeriut pa titullar për një pjesë të madhe të periudhës zgjedhore.

⁸ Në 3 dhjetor 2016, në bazë të të dhënave të popullsisë nga Ministria e Brendshme (MB), KQZ-ja llogariti numrin e mandateve për çdo qark, që u shtri nga 3 në Kukës në 34 në Tiranë. Kuvendi e miratoi numrin e mandateve për çdo qark më 20 prill, pesë javë pas afatit ligjor.

⁹ Disa parti të vogla ishin në favor të lejimit të paraqitjes së listave të kandidatëve vetëm për qarqe specifike.

¹⁰ Mandatet shpërndahen në bazë të kombinimit të formulave d'Hondt dhe Sainte-Laguë.

¹¹ Përfshirë ligjin "Për partitë politike" të vitit 2000, ligjin "Për tubimet" të vitit 2001, ligjin "Për mediat audiovizive" të vitit 2013, ligjin "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike (i ashtuquajtur Ligji për Dekriminalizimin) të vitit 2015, ligjin "Për barazinë gjinore në shoqëri" të vitit 2008, si dhe dispozitat përkatëse të Kodit Penal të vitit 1995.

¹² Përfshirë Marrëveshjen Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (ICCPR) të vitit 1966, Konventën mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racial të vitit 1965, Konventën mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit për Gratë (CEDAW) të vitit 1979, Konventën e KB kundër Korrupsionit (UNCAC) të vitit 2003, Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (CRPD) të vitit 2006, dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ECHR) të vitit 1950. Shqipëria është edhe anëtare e Komisionit të Venecias dhe Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO) të Këshillit të Evropës.

it, procesit i mungoi përfshirja, sepse disa propozime nga partitë e vogla dhe shoqëria civile nuk u morën në konsideratë.

Përgjithësisht, Kodi Zgjedhor përbën një bazë të përshtatshme për zhvillimin e zgjedhjeve demokratike, por mangësitë e identifikuara në raporte të mëparshme të OSBE/ODIHR-it nuk u trajtuan para këtyre zgjedhjeve. Këtu përfshihen rekomandimet për përmirësimin e kuotave të përfaqësimit gjinor në listat e kandidatëve, forcimin e pavarësisë dhe profesionalizmit të administratës zgjedhore, forcimin e transparencës për financimin e fushatës dhe qartësimin e përgjegjësive për ankimet zgjedhore. Mungesa e qartësisë së disa dispozitave të Kodit Zgjedhor ndikoi negativisht në procesin zgjedhor.¹³

Pas marrëveshjes politike të 18 majit, në 22 maj u miratuan ndryshime në Ligjin për Partitë Politike, Ligjin për Median Audio-vizive dhe Kodin Penal. Këto ndryshime sollën rregullime të reja mbi fushatën, financimin e fushatës, transmetimin e reklamave politike nga mediat audio-vizive, si dhe parashikuan vepra të reja penale në fushën e zgjedhjeve dhe rritën sanksionet për ato ekzistuese.¹⁴ Thelbi i ndryshimeve u mirëprit nga shumë bashkëbisedues të MVZ-së të OSBE/ODIHR-it. Si zhvillim pozitiv, disa prej ndryshimeve trajtuan rekomandime të mëparshme të OSBE/ODIHR-it në lidhje me transparencën dhe llogaridhënien për fushatën zgjedhore, si dhe masa më të qëndrueshme për të parandaluar presionin mbi punonjësit e sektorit publik dhe praktikantët korruptivë zgjedhore.

Megjithatë, marrëveshjes politike të 18 majit iu dha fuqia e ligjit në dëm të sundimit të ligjit (shih *Regjistrimi i kandidatëve*). Të gjitha ndryshimet u votuan brenda një dite, në kundërshtim me procedurën ligjore të parashikuar në Kushtetutë.¹⁵ Në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së dhe standardet e Këshillit të Evropës, procesit i mungoi transparenca dhe konsultimi me aktorët përkatës, ndërsa miratimi i vonë i ndryshimeve krijoi vështirësi reale për zbatimin e aspekteve kyçe të administrimit të zgjedhjeve.¹⁶ Ndryshimet legjislativë të minutës së fundit cenuan sigurinë juridike dhe përputhshmërinë e kuadrin ligjor, pasi disa prej dispozitave të reja nuk ishin në harmoni me Kodin Zgjedhor.¹⁷ Shumë prej bashkëbiseduesve të MVZ-së të OSBE/ODIHR-it theksuan nevojën e përfshirjes së ekspertëve jo vetëm nga partitë e mëdha parlamentare dhe analizimit të politikave të ndryshme, ndër të cilat ato për votimin elektronik, përpara reformës së ardhshme.

Autoritetet duhet të ndërmarrin një reformë zgjedhore përfshirëse, të zhvilluar në kohë dhe të mbështetur në analiza të plota të politikave, me qëllim trajtimin e rekomandimeve të këtij raporti dhe raporteve të mëparshme të OSBE/ODIHR-it. Dispozitat në ligje të ndryshme që kanë të bëjnë me zgjedhjet duhet të harmonizohen, veçanërisht ato në lidhje me fushatën, financimin e fushatës dhe median.

¹³ Për shembull, detyrimi që "zyrtarë të lartë" të administratës publike duhet të heqin dorë nga detyra para se të kandidojnë (neni 63.4 i Kodit Zgjedhor) është i paqartë, sepse ligji nuk i përkufizon qartë këta zyrtarë; kuptimi "shumicë qeverisëse" (neni 95.2) për qëllime të caktimit të anëtarëve të grupeve të numërimit është gjithashtu i paqartë dhe kjo çështje u dërgua nga LSI-ja në gjykatë (shih *Ankimet dhe apelimet*).

¹⁴ Veprat e reja penale të parashikuara në Kodin Penal përfshijnë shpërdorimin e funksionit publik për veprimtari zgjedhore dhe keqpërdorimin e dokumenteve të identitetit të personave të tjerë. Gjithashtu, u parashikuan ndalime më të hollësishme për shitjen dhe blerjen e votës.

¹⁵ Sipas Kushtetutës (neni 83), procedura e përshpejtuar për të miratuar projektligje nuk mund të jetë më pak se një javë. Kodet nuk mund të miratohen apo ndryshohen me procedurë të përshpejtuar.

¹⁶ Paragrafi 5.8 i Dokumentit të Kopenhagenit të OSBE-së të vitit 1990 i angazhon Shtetet pjesëmarrëse të miratojnë legjisllacion "në përfundim të një procedure publike". Seksioni II.2.b i Kodit të Praktikës së Mirë në Çështje Zgjedhore i Komisionit të Venecias i vitit 2002 rekomandon që "elementet themelore të ligjit zgjedhor ... nuk duhet të jenë të hapur për ndryshime më pak se një vit para zgjedhjeve".

¹⁷ Veçanërisht dispozitat e reja mbi reklamën politike gjatë fushatës në median audio-vizive (shih *Media*). Sipas Kushtetutës (neni 81), Kodet kanë peshë më të madhe ligjore si akte të miratuara me shumicë të cilësuar të deputetëve.

V. ADMINISTRATA ZGJEDHORE

Zgjedhjet u administruan nga një sistem administrimi me tre nivele: KQZ-ja, 90 Komisione të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ) dhe 5,362 Komisione të Qendrave të Votimit (KQV). Votat u numëruan nga Grupet e Numërimit në 90 Vende të Numërimit të Votave (VNV).

Gratë ishin të nënpërfaqësuar në administratën zgjedhore, veçanërisht në pozicionet vendimmarrëse. Dy nga shtatë anëtarët e KQZ-së dhe rreth një e treta e anëtarëve të KZAZ-ve ishin gra. Megjithatë, vetëm 20 për qind e grave në KZAZ kishin pozicione drejtuese, dhe asnjë në KQZ.¹⁸ Vëzhguesit e MNVZ-së raportuan një përqindje të ngjashme të grave në KQV (21 për qind, përfshirë 18 për qind të kryetareve në KQV-të e vizituara).¹⁹

Duhen bërë përpjekje për nxitjen e përfaqësimit të baraspeshuar gjinor në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore, përfshirë pozicionet vendimmarrëse.

A. KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KQZ-ja është organ i përhershëm, përgjegjës për zhvillimin e përgjithshëm të zgjedhjeve. Të shtatë anëtarët e tij zgjidhen nga Kuvendi. Tre anëtarë propozohen nga shumica parlamentare dhe tre të tjerë propozohen nga opozita parlamentare. Sipas ligjit, kryetari zgjidhet nga Kuvendi përmes një procesi të hapur aplikimi.²⁰ Si pjesë e marrëveshjes politike, Kuvendi zëvendësoi më 22 maj Kryetarin e KQZ-së 35 ditë para ditës së zgjedhjeve me një anëtar tjetër të KQZ-së, përfaqësues të opozitës, duke anashkaluar procedurën e parashikuar ligjore.

Pas marrëveshjes, KQZ-ja dhe administrata e saj u përballën me një sërë sfidash komplekse ligjore, institucionale dhe financiare, dhe iu desh të punonin nën kufizime të konsiderueshme kohore.²¹ Nevoja për të rimiruar vendimet e marra para ndryshimit të datës së zgjedhjeve dhe për të miratur rregulla të reja e rëndoi edhe më tej KQZ-në dhe administratën e saj.²² KQZ-ja miratoi gjithsej rreth 500 vendime.

Pavarësisht këtyre sfidave, KQZ-ja i zbatoi detyrat kryesore të e saj. Ajo ishte e gatshme në dhënien e informacionit, veprimi në mënyrë të hapur, sesionet publike u transmetuan drejtpërdrejt online dhe vëzhguesit, media dhe përfaqësuesit e partive politike morën pjesë rregullisht në to. Megjithatë, KQZ-ja nuk mori masa për të qartësuar mospërputhjet në lidhje me reklamat politike në median audiovizive. Për emërimin e anëtarëve të KZAZ-ve nuk u respektua gjithmonë kriteri i papajtueshmërisë i parashikuar në Kodin Zgjedhor.²³ Më tej, KQZ-ja pati mospërputhje në qasjen e saj për regjistrimin e kandidatëve dhe vendosjen e masave për shkelje të kuotave të përfaqësimit gjinor në listat e kandidatëve (shih *Regjistrimi i kandidatëve*). Në tërësi, kjo krijoi shqetësime për efektshmërinë e

¹⁸ Me ligj, të paktën 30 për qind e anëtarëve të KZAZ-ve të propozuar nga partitë më të mëdha të shumicës dhe të opozitës parlamentare duhet të jenë gra.

¹⁹ Në paragrafin 40.4 të Dokumentit të Moskës të OSBE-së të vitit 1991, Shtetet pjesëmarrëse pohojnë se është "synimi i tyre të arrijnë jo vetëm *de jure*, por edhe *de facto* barazinë e mundësive midis burrave dhe grave dhe të nxisin masa të efektshme për këtë qëllim". Shih edhe nenin 7(b) të CEDAW dhe paragrafin 26 të Rekomandimit të Përgjithshëm 23 të Komitetit të CEDAW të vitit 1997.

²⁰ Në nëntor 2016, ish-nënkryetari i KQZ-së i propozuar nga PS-ja u zgjodh kryetar.

²¹ Për shembull, KQZ-ja mori 10 milion lekë (rreth 74,000 euro; 1 euro = rreth 135 lekë) nga qeveria, që së bashku me buxhetin rezervë të KQZ-së duhej të shpenzohej për ekspertët e monitorimit të financave të fushatës së re.

²² Për shembull, rregullat për monitorimin e financave të fushatës, qartësimin e rregullave të reja të fushatës dhe formularët tip.

²³ Deputetët, kandidatët, kryetarët e bashkive, personeli ushtarak, policor dhe i shërbimit sekret, si dhe anëtarët apo sekretarët e një komisioni tjetër zgjedhor nuk mund të shërbejnë në KZAZ. Megjithatë, për shembull KZAZ-të 3, 48, dhe 87 kishin anëtarë dhe sekretarë të regjistruar si kandidatë përkatësisht nga PD-ja, LSI-ja dhe PS-ja.

KQZ-së dhe konsistencën e vendimeve të saj, duke e ulur besimin e publikut të administratës zgjedhore.

Fushata e KQZ-së për informimin e zgjedhësve trajtoi procedurat e ditës së zgjedhjeve, përgjegjësitë për shkeljet që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor dhe dha informacion që shkrajonte votimin familjar. Si zhvillim pozitiv, disa reklama televizive u shoqëruan me gjuhën e shenjave. Megjithatë, informacioni për zgjedhësit erdhi ndjeshëm me vonesë dhe pati shikueshmëri të kufizuar.

B. KOMISIONET E NIVELEVE TË ULËTA

KZAZ-të përbëhen nga shtatë anëtarë dhe një sekretar, të propozuar nga shumica dhe opozita parlamentare. Formula e propozimit të anëtarëve të KZAZ-ve është e njëjtë me atë të KQZ-së.²⁴ Ngritja e komisioneve të niveleve të ulëta pati probleme dhe përfundoi kohë pas afateve ligjore. Partitë e opozitës me të drejtë propozimi refuzuan të paraqisnin emrat për anëtarë të KZAZ-ve brenda afatit fillestar. Për këtë arsye, KQZ-ja i ngriti KZAZ-të me vetëm katër anëtarë dhe një sekretar duke përzgjedhur aplikime nga qytetarë që e gëzonin këtë të drejtë, në përputhje me kërkesat ligjore. Pas marrëveshjes politike të 18 majit, partitë e opozitës e patën përsëri mundësinë të propozonin emrat për anëtarë. Për rrjedhojë, komisionerët që ishin përzgjedhur nga KQZ-ja u zëvendësuan nga ata të propozuar nga partitë e opozitës, edhe pse me vonesa të ndjeshme nga ana e partive.²⁵ Pavarësisht një rekomandimi të kahershëm të OSBE/ODIHR-it, partitë kanë të drejtë t'i tërheqin të propozuarit e tyre nga KZAZ-të në çdo kohë nëse dëshirojnë. Deri më 24 qershor, u zëvendësuan 119 nga 720 (16.5 për qind) e anëtarëve dhe sekretarëve të KZAZ-ve, kryesisht me kërkesë të partive.²⁶

Asnjë nga të 90 KZAZ-të nuk mundi t'i ngrinte KQV-të dhe grupet e numërimit brenda afatit ligjor.²⁷ Ligji nuk u siguron KZAZ-ve ndonjë mekanizëm alternativ që të plotësojnë vendet bosh në KQV-të dhe grupet e numërimit në rast se anëtarët e tyre nuk emërohen në kohë nga partitë. Kjo e lë formimin e KQV-ve dhe të grupeve të numërimit në një masë të madhe në varësi të vullnetit politik. 720 KQV nuk ishin ngritur ende dy ditë para ditës së zgjedhjeve. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u informua se të gjitha partitë i vonuan propozimet nga frika e ndonjë korrupsioni të mundshëm të komisionerëve të tyre nga kundërshtarët, çka reflekton një mosbesim të thellë mes partive politike. Vonesat në propozime u përdorën edhe për të anashkuar ndalimin ligjor për zëvendësimin e anëtarëve të KQV-ve.²⁸ Ky është tregues i dobësive sistematike të një administrate zgjedhore tejte të politizuar.²⁹

Ligji mund të ndryshohet për të lejuar emërimin mbi baza jopartiake të komisionerëve zgjedhorë dhe anëtarëve të grupeve të numërimit. Kodi Zgjedhor duhet të ndryshohet për të ndaluar zëvendësimin diskrecional të anëtarëve të KZAZ-ve nga ana e partive propozuese. Gjithashtu, duhet t'i kushtohet vëmendje mundësisë së vendosjes së mekanizmave alternativë për emërimin e anëtarëve të KQV-ve dhe të grupeve të numërimit në rast se partitë politike nuk propozojnë emra.

²⁴ Me përjashtimin që në gjysmën e KZAZ-ve kryetari propozohet nga partia më e madhe e shumicës parlamentare, dhe në gjysmën tjetër nga partia më e madhe e opozitës parlamentare. Zëvendëskryetari dhe sekretari i përkasin partisë politike që nuk kryeson KZAZ-në përkatëse.

²⁵ KQZ-ja e finalizoi ngritjen e KZAZ-ve pasi PR-ja paraqiti propozimet e saj në 16 qershor.

²⁶ Kjo bie ndesh me Seksionin II.3.1.f të Kodit të Praktikave të Mira në Çështje Zgjedhore të vitit 2002 të Komisionit të Venecias, i cili shprehet se "organet që emërojnë anëtarët e komisioneve zgjedhore nuk duhet të jenë të lirë t'i shkarkojnë sipas vullnetit të tyre".

²⁷ Më 13, 15, 19, dhe 21 qershor, KQZ-ja nxori deklaratë që u bënin thirrje partive politike të propozonin anëtarët e KQV-ve. KQV-të dhe grupet e numërimit duhet të ngriheshin përkatësisht brenda datave 5 dhe 15 qershor.

²⁸ Kodi Zgjedhor nuk i lejon partitë politike t'i tërheqin propozimet e tyre për anëtarë të KQV-ve.

²⁹ Paragrafi 20 i Komentit të Përgjithshëm 25 të CCPR të vitit 1996 për ICCPR-në kërkon që "Duhet të krijohet një autoritet i pavarur zgjedhor për të mbikëqyrur procesin zgjedhor dhe për t'u siguruar që ai zhvillohet në mënyrë të ndershme, të paanshme dhe në përputhje me ligjet në fuqi që janë në përputhje me Paktin".

MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vizitoi 86 KZAZ para ditës së zgjedhjeve dhe vuri re se disave prej tyre u mungonin mjediset dhe pajisjet e duhura, dhe disa raportuan se nuk kishin marrë fondet e mjaftueshme që t'i administrojnë zgjedhjet në kohë dhe se, në disa raste, u ishte dashur të përdornin fondet personale të vetë anëtarëve. Përfaqësuesit e disa administratave vendore nuk i lejuan punonjësit e tyre të përmbushnin funksionin si anëtarë të KZAZ-së, me pretendimin se nëpunësit publikë nuk mund të angazhohen në veprimtari politike, në kundërshtim me sqarimet e KQZ-së.³⁰

KQZ-ja ofroi trajnim për anëtarët e KZAZ-së, të cilin MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it e vlerësoi si me pjesëmarrje të mirë por me dallime në cilësi. Ndërkohë që disa trajnime ishin ndërveprues dhe të mirëorganizuar, disa të tjerë ishin me cilësi të dobët dhe kishin mungesa të materialeve të trajnimit. KQZ-ja organizoi trajnime për KQV-të në periudhën 17 - 22 qershor, ndërsa KZAZ-të ishin ende në procesin e ngritjes së KQV-ve. Kjo pati ndikim negativ tek efektshmëria e trajnimeve, pasi disa trajnime ose nuk u zhvilluan fare, ose patën pjesëmarrje të ulët.

Për të forcuar kapacitetet profesionale të komisioneve zgjedhore, KQZ-ja mund të ofrojë rregullisht trajnime me certifikim për anëtarë të mundshëm të KZAZ-ve, KQV-ve dhe grupeve të numërimit, dhe të krijojë një regjistër me personat e certifikuar.

VI. REGJISTRIMI I ZGJEDHËSVE

Të drejtën e votës e kanë shtetasit shqiptarë të cilët në ditën e zgjedhjeve kanë mbushur moshën 18 vjeç ose më shumë. Nga e drejta e votës përjashtohen shtetasit që vuajnë dënime me burg për kryerjen e veprave të caktuara penale.³¹ Kufizimet e të drejtës së votës për shtetasit që janë shpallur të paafte mendërisht me vendim gjykatë bien ndesh me detyrimet ndërkombëtare që ndalojnë diskriminimin për shkak të paafetësisë.³² Shqipëria ka një sistem pasiv të regjistrimit të zgjedhësve. Megjithatë, në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së, zgjedhësit mbi 100 vjeç hiqen automatikisht nga lista e zgjedhësve dhe duhet të konfirmojnë në mënyrë aktive të dhënat e tyre në mënyrë që të rifuten në lista.³³

Kufizimet e së drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuar mendore duhet të hiqen. Duhet të ndërpritet heqja automatikisht e zgjedhësve të moshës 100 vjeç apo më shumë nga listat e zgjedhësve, dhe detyrimi për të verifikuar të dhënat e këtyre zgjedhësve duhet të vendoset mbi shtetin.

Listat e zgjedhësve mbështeten në ekstraktet e nxjerra nga baza elektronike e të dhënave të Regjistrimit Kombëtar të Gjendjes Civile, që mbahet nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në MB (DPGJC). Pas dekretimit të datës së zgjedhjeve, DPGJC-ja publikoi çdo muaj ekstraktet e përditësuara

³⁰ MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it mori raportime të tilla nga Berati, Fieri, Kukësi dhe Shkodra. Në deklaratat e saj të [27 majit](#) dhe [10 qershorit](#), KQZ-ja sqaroi se punësimi në administratën vendore nuk binte ndesh me të qenit anëtarë në komisionet zgjedhore dhe u bëri thirrje drejtuesve të administratave vendore të miratonin kërkesat për leje të komisionerëve.

³¹ Ligji për Dekriminalizimin solli kufizime për të drejtën e votës për qytetarët që vuajnë dënime me burg për krime të parashikuara në rreth 60 nene të Kodit Penal. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u informua se, për rrjedhojë, e drejta e votës iu hoq 1,371 personave.

³² Shih nenet 12 dhe 29 të CRPD-së të vitit 2006. Shih edhe paragrafin 9.4 të Komunikatës No. 4/2011 të Komitetit të CRPD-së të vitit 2013 (*Zsolt Bujdosó dhe pesë të tjerë kundër Hungarisë*) që thotë se: "Neni 29 nuk parashikon ndonjë kufizim të arsyeshëm, as nuk lejon ndonjë përjashtim për ndonjë grup personash me aftësi të kufizuar. Prandaj, përjashtimi nga e drejta e votës për shkak të një aftësie të kufizuar, të perceptuar apo reale, psikosociale apo intelektuale, përfshirë kufizimin sipas një vlerësimi të individualizuar, përbën diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar".

³³ MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u informua se 1,480 zgjedhës mbi 100 vjeç u hoqën nga lista e zgjedhësve nga dhjetori 2016 deri në 24 maj 2017. Paragrafi 5.9 i Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990 thotë: "Të gjithë personat janë të barabartë para ligjit dhe gëzojnë të drejtë pa diskriminim për mbrojtje të barabartë nga ligji". Shih edhe nenin 26 të ICCPR-së.

të listës së zgjedhësve, duke u lejuar zgjedhësve të regjistronin çdo ndryshim pranë zyrave vendore të gjendjes civile. Korrigjimet e të dhënave të zgjedhësve mund të bëhen deri në 40 ditë përpara datës së zgjedhjeve. Pas këtij afati, dhe deri në 24 orë para ditës së zgjedhjeve, kërkesat për të korrigjuar ose për t'u përfshirë në listën e zgjedhësve mund të bëhen vetëm me vendim të gjykatave të rretheve. U paraqitën rreth 600 kërkesa për përfshirje në listë, kryesisht nga të burgosur, dhe rreth gjysma e kërkesave u pranuan.³⁴ Zgjedhësit mund të verifikonin të dhënat e tyre edhe në faqen e internetit të KQZ-së. Numri i përfundimtar i zgjedhësve të regjistruar ishte 3,452,324.

Në janar të vitit 2017, KQZ-ja caktoi dy auditë për të vlerësuar saktësinë e listave të zgjedhësve, të cilët raportuan problemin e vazhdueshëm të kodeve të pasakta të adresave.³⁵ Nga bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it nuk u ngritën problematika domethënëse mbi saktësinë e listave të zgjedhësve, me përjashtim të pengesave për komunitetin Rom (Shih *Pjesëmarrja e pakicave kombëtare*) si dhe të çështjes së kahershme të të dhënave të shumëfishta.

Zgjedhësit përfshihen në listat e zgjedhësve të qendrave të votimit pranë vendbanimit të tyre dhe mund të votojnë vetëm aty, pa patur mundësi të votojnë me anë të postës, kutisë së lëvizshme të votimit, apo të votojnë nga jashtë vendit.³⁶ U ngritën gjithsej 21 qendra të posaçme votimi pranë spitaleve, burgjeve dhe qendrave të paraburgimit.

Listat përfundimtare të zgjedhësve të lidhura me datën fillestare të zgjedhjeve, 18 qershorin, u printuan dhe u afishuan në qendrat e votimit nga KZAZ-të përkatëse. Pas ndryshimit të datës së zgjedhjeve, u hartuan dhe u printuan lista të reja që përfshinë zgjedhësit që mbushnin moshën 18 vjeç deri në datën 25 qershor. Megjithatë, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vuri re se listat e reja shpesh nuk u afishuan në qendrat e votimit, ose u afishuan vonë.

Bashkive iu kërkua t'i njoftonin zgjedhësit për qendrën e tyre përkatëse të votimit, por disa bashkëbisedues të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it u shprehën se këto njoftime jo gjithmonë u shpërndanë.³⁷ KQZ-së iu desh të ndryshonte vendndodhjen e rreth 430 qendrave të votimit.³⁸ Ndryshimet e vona të vendndodhjes së qendrave të votimit vonuan afishimin e listave përfundimtare të zgjedhësve dhe shpërndarja jo e njëtrajtshme e njoftimeve për zgjedhësit kufizoi mundësinë e shqyrtimit të listave të zgjedhësve nga publiku. Në ditën e zgjedhjeve, zgjedhësit që ishin të regjistruar në qendrën e gabuar të votimit u ridrejtuar për në qendrën e duhur të votimit në 17 për qind të vëzhgimeve.

Duhet intensifikuar përpjekjet për të siguruar saktësinë e të dhënave për të gjithë zgjedhësit, përfshirë caktimin e kodeve të sakta të adresave dhe zgjidhjen e çështjes së të dhënave të shumëfishta. Duhet krijuar gjithashtu një sistem i efektshëm i shpërndarjes së njoftimit të zgjedhësve që të sigurojë informimin e tyre në kohë se ku mund të verifikojnë të dhënat në listën e zgjedhësve dhe vendndodhjen e qendrës së tyre të votimit.

³⁴ Ministria e Drejtësisë lehtësoi procesin e kërkesave drejtuar gjykatave nga të burgosurit për përfshirje në listën e zgjedhësve. Një numër i madh i kërkuesve të refuzuar nuk e gëzonin të drejtën e votës në bazë të Ligjit për Dekriminalizimin.

³⁵ Auditët e KQZ-së raportuan se kodet e vendbanimit të 289,484 zgjedhësve të regjistruar mbetën të paverifikuara për shkak të mungesës së kapaciteteve të auditëve për ta realizuar verifikimin në terren në mënyrë të detajuar.

³⁶ Zgjedhësit që e kanë vendbanimin jashtë vendit mbeten të regjistruar në listën e zgjedhësve sipas adresës së tyre të fundit të regjistruar.

³⁷ Afati ligjor për shpërndarjen e njoftimeve për zgjedhësit ishte data 5 mars.

³⁸ Ndryshimet u bënë ndër të tjera për shkak të mjediseve të papërshtatshme apo me kërkesë të pronarëve të ambienteve të votimit.

VII. REGJISTRIMI I KANDIDATËVE

Çdo zgjedhës me të drejtë vote mund të kandidojë në zgjedhje, me përjashtim të atyre të cilëve iu është kufizuar kjo e drejtë nga Ligji për Dekriminalizimin.³⁹ Kushtetuta rendit gjithashtu kategoritë e zyrtarëve, postet e të cilëve janë në papajtueshmëri me të drejtën për të kandiduar.⁴⁰

Kandidatët mund të caktohen nga partitë politike, koalicionet e partive politike apo mund të kandidojnë në mënyrë të pavarur nëpërmjet propozimit nga një grup zgjedhësish.⁴¹ Listat e kandidatëve për partitë joparlamentare duhet të mbështeten nga nënshkrimet e 5,000 zgjedhësve në rang vendi dhe kandidatët e pavarur nga një për qind e zgjedhësve të qarkut të tyre përkatës, por jo më shumë se 3,000 zgjedhës. Në përputhje me kërkesat ligjore, KQZ-ja verifikoi pesë për qind të nënshkrimeve të paraqitura mbështetëse.⁴² Ligji nuk shprehet se kush mund ta vëzhgojë procesin e verifikimit. Gjatë mbledhjes së datës 7 maj, KQZ-ja hodhi poshtë kërkesën e anëtarëve të opozitës në KQZ për verifikim të mëtejshëm të nënshkrimeve për pesë parti.⁴³ Pamundësia që aktorë të tjerë të ndjekin verifikimin e nënshkrimeve mbështetëse nuk siguron transparencë të plotë të procesit.

Për të forcuar më tej transparencën dhe besimin në proces, duhet t'i kushtohet vëmendje dhënies së mundësisë aktorëve zgjedhorë për të vëzhguar drejtpërdrejt verifikimin e nënshkrimeve mbështetëse të kandidatëve. Procesi duhet të përkufizohet qartë dhe të përfshijë hapat që duhet të ndiqen në rast se ka ankime.

KQZ-ja i përmbushi detyrimet e saj sipas Ligjit për Dekriminalizimin për verifikimin e informacionit në formularët e vetëdeklarimit të kandidatëve, duke kërkuar të dhëna nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile.⁴⁴ Megjithatë, disa bashkëbisedues të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it paraqitën shqetësime në lidhje me përputhshmërinë, kohën e dhënies dhe cilësinë e nënshkrimeve mbështetëse dhe dëshmi të penalitetit të kandidatëve. Para ditës së zgjedhjeve, një numër bashkëbiseduesish të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it theksuan rolin e individëve që pretendohet se kanë lidhje me krimin e organizuar në procesin zgjedhor. Kjo mbeti një çështje shqetësuese për këta bashkëbisedues edhe pas zgjedhjeve, duke qenë se disa prej këtyre individëve u zgjodhën deputetë.

Më 7 maj, KQZ-ja përfundoi regjistrimin e listave të kandidatëve për 15 parti, në përputhje me afatet kohore fillestare.⁴⁵ Një ditë më pas, ajo miratoi përmbajtjen e fletës së votimit, një vendim i cili u pa si i politizuar nga disa bashkëbisedues të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it pasi KQZ-ja nuk la kohë për ankime të mundshme kundër regjistrimit. Më 28 dhe 30 maj, pas marrëveshjes politike dhe pa ndryshim ligjor të afateve të regjistrimit, KQZ-ja regjistroi edhe listat e kandidatëve të PR-së, Partisë

³⁹ Sipas Ligjit për Dekriminalizimin, shtetasit e dënuar për krime të caktuara apo të deportuar, edhe në mungesë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, nga një shtet anëtar i BE-së, Australia, Kanadaja dhe Shtetet e Bashkuara, si dhe ata që janë në kërkim ndërkombëtar, përjashtohen nga e drejta për të kandiduar.

⁴⁰ Nenet 63 dhe 69 të Kodit Zgjedhor dhe të Kushtetutës, përkatësisht, rendisin Presidentin, zyrtarët e lartë të administratës publike, gjyqtarët, prokurorët, personelin ushtarak, policor e të sigurisë kombëtare, diplomatët, kryetarët e bashkive në detyrë dhe anëtarët e komisioneve zgjedhore.

⁴¹ Grupet e zgjedhësve duhet të përbëhen nga të paktën nëntë zgjedhës nga një zonë zgjedhore.

⁴² Seksioni I.1.3.iv i Kodit të Praktikave të Mira në Çështje Zgjedhore të vitit 2002 të Komisionit të Venecias rekomandon që "Procesi i kontrollit duhet që, në parim, të mbulojë të gjitha nënshkrimet".

⁴³ KQZ-ja e informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se partitë dhe vëzhguesit nuk kanë të drejtë për të ndjekur procesin e verifikimit të nënshkrimeve dhe se verifikimi kryhet vetëm nga personeli administrativ i KQZ-së. Sipas Seksionit I.1.3.iii të Kodit të Praktikave të Mira në Çështje Zgjedhore të vitit 2002 të Komisionit të Venecias "Kontrolli i nënshkrimeve duhet të përcaktohet nga rregulla të qarta".

⁴⁴ Sipas rastit, KQZ-ja mund të kërkojë verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme.

⁴⁵ KQZ-ja mori lista kandidatësh nga 17 parti, dy prej të cilave (Partia e Unitetit Kombëtar dhe Partia e Moderuar Socialiste) nuk i riparaqitën listat e tyre pas kthimit nga KQZ-ja për korrigjime. Në këto zgjedhje nuk garoi asnjë kandidat i pavarur.

Bashkimi Demokristian Shqiptar (PBDSh) dhe PD-së.⁴⁶ Në të njëjtën kohë, një kandidati të pavarur të mundshëm iu mohua regjistrimi për shkak të dorëzimit me vonësë të dokumenteve.⁴⁷ Në 5 qershor, Partia *Forca Rinia* paraqiti kërkesë për regjistrimin e listës së saj të kandidatëve, e cila u refuzua nga KQZ-ja me arsyetimin se partia nuk i kishte paraqitur të gjitha dokumentet e kërkuara brenda afatit ligjor.

Për çdo listë kandidatësh zbatohet kriteri i kuotës gjinore, si një mjet për të trajtuar çështjen e nënprfaqësimit politik të grave.⁴⁸ Për këtë kërkohet që të paktën një grua dhe një burrë të jenë në tri vendet e para në listë, dhe në listën e çdo qarku të jenë të paktën 30 për qind e kandidatëve nga secila gjini. KQZ-ja vuri sanksione prej 1 milion lekësh ndaj PS-së dhe LSI-së për mosrespektimin e kriterit të kuotës gjinore respektivisht në qarkun e Beratit dhe atë të Tiranës. Megjithatë, KQZ-ja nuk i vendosi sanksione PD-së për mosrespektim të kuotës gjinore në të 12 qarqet e vendit, duke cenuar vlerën e masës për promovimin e kandidateve femra dhe nevojën që partitë të konkurrojnë në kushte të barabarta, në kundërshtim me angazhimet e OSBE-së.⁴⁹ Ligji nuk e parashikon mosregjistrimin e një partie për shkak të mosrespektimit të kriterit të kuotës gjinore.

Gjithsej u regjistruan 18 parti dhe 2,666 kandidatë, përfshirë 1,073 gra (40 për qind). Megjithatë, vetëm 39 gra (ose 27.9 për qind) u zgjodhën deputete. Si zhvillim pozitiv, 7 nga 15 anëtarët e kabinetit të ri qeveritar ishin gra. Në përgjithësi, ndonëse përfshirës në një shkallë të madhe, regjistrimi i kandidatëve vuajti nga zbatimi përzgjedhës dhe jo i njëtrajtshëm i ligjit dhe, në disa raste, u mbështet në marrëveshjen politike dhe jo në ligj.

Mund t'i kushtohet vëmendje forcimit të masave të posaçme ekzistuese për rritjen e pjesëmarrjes politike të grave, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kjo mund të përfshijë detyrimin për alternimin e kandidatëve burra dhe gra në lista, si dhe parashikimin dhe zbatimin e sanksioneve të efektshme dhe proporcionale, përfshirë mosregjistrimin e listave, për mosrespektim të këtyre masave.

VIII. FUSHATA ZGJEDHORE

Pas ndryshimit të datës së zgjedhjeve, fushata filloi zyrtarisht në 26 maj⁵⁰ megjithëse ishin vëzhguar disa raste të bërjes fushatë para afateve ligjore.⁵¹ Fushata ofroi alternativa të shumëllojshme politike. Në të gjithë vendin u zhvillua një fushatë domethënëse, ndonëse dukshmëria ra për shkak të pranisë së

⁴⁶ Në përputhje me Kodin Zgjedhor dhe datën e re të zgjedhjeve, partitë politike duhej të regjistroheshin jo më vonë se data 16 prill dhe listat e kandidatëve jo më vonë se data 16 maj.

⁴⁷ Dokumentet u dorëzuan më 25 maj. KQZ-ja arsyetoi se kishte kaluar afati ligjor i përcaktuar me ligj.

⁴⁸ Para këtyre zgjedhjeve, gratë kishin 33 nga 140 mandatet e deputetëve, 8 nga 21 postet ministrore dhe 9 nga 61 kryetarët e bashkive.

⁴⁹ Paragrafi 7.6 i Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990 i angazhon Shtetet pjesëmarrëse t'u sigurojnë "partive politike... garancitë e nevojshme ligjore për t'u mundësuar të konkurrojnë me njëra-tjetrën mbi bazat e trajtimit të barabartë para ligjit dhe para autoriteteve". Neni 4.1 i CEDAW parashikon që miratimi "i masave të posaçme të përkohshme për përshpejtimin *de facto* të barazisë midis burrave dhe grave nuk do të konsiderohet diskriminim." Paragrafi 3 i Vendimit 7/09 të Këshillit të Ministrave të OSBE-së të vitit 2009 u bën thirrje shteteve pjesëmarrëse të "inkurajojnë të gjithë aktorët politikë për të nxitur pjesëmarrjen e grave dhe burrave në parti politike, me qëllim arritjen e një përfaqësimi më të balancuar gjinor në postet e zgjedhura publike".

⁵⁰ Fushata zgjedhore fillon 30 ditë dhe përfundon 24 orë para ditës së zgjedhjeve.

⁵¹ Nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u vërejtën në Peshkopi njoftime që ftonin zgjedhësit në tubime në 12 maj me kandidatin e PDIU-së në mjediset e shkollës. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vëzhgoi takime të PS-së me zgjedhësit në 19 maj në Korçë dhe në 23 maj në Durrës si dhe një miting të LSI-së në Kukës në 25 maj.

kufizuar të posterave dhe flamujve në format të madh.⁵² Fushata nisi në mënyrë paqësore, por më vonë ndodhën një numër incidentesh të dhunshme.⁵³

Liria e tubimit u respektua.⁵⁴ Partitë dhe kandidatën ishin të lirë të shprehnin pikëpamjet e tyre, ku fushatat më aktive u organizuan nga PD-ja, LSI-ja dhe PS-ja. Një fushatë mbarëkombëtare u organizua edhe nga PDIU-ja. Partia Lista e Barabartë (LIBRA) bëri fushatë më së shumti në 55 qytete. Partitë e vogla e kufizuan fushatën te vizitat derë më derë dhe te përdorimi i medias sociale.⁵⁵

Gratë ishin aktive dhe të dukshme në fushatë dhe disa veprimtari u drejtoheshin në mënyrë specifike zgjedhëseve femra.⁵⁶ Megjithatë, gratë ishin të nënpërfaqësuar në mënyrë të dukshme. Asnjë nga kryetarët e 18 partive që garuan në zgjedhje nuk ishte grua. Gratë kandidate morën pak vëmendje nga media; kanalet televizive publike dhe private të monitoruara nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u kushtuan grave 13 për qind të pasqyrimit të fushatës.

Gjatë gjithë fushatës, mosbesimi mbizotërues ndër partitë politike dhe kandidatët nxiti akuza të ndërsjella personale në dëm të paraqitjes së platformave konkrete të partive. Fushata e pjesës më të madhe të garuesve u përqendrua te personaliteti i kandidatëve individualë, veprimet dhe reputacioni i tyre në të shkuarën. Aktorët kryesorë të fushatës në median sociale të monitoruar ishin kryetari i PS-së Edi Rama, kryetari i PD-së Lulzim Basha, dhe ish-kryetari i LSI-së Ilir Meta, ndërsa platforma më e përdorur ishte Facebook-u. Faqet e kryetarëve ishin më aktive se faqet e partive përkatëse.⁵⁷

Disa bashkëbisedues të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it shprehën shqetësim se individë me të shkuar kriminale ende luanin rol domethënës në fushatë, si kandidatë ose si mbështetës. Shumë bashkëbisedues të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it shprehën gjithashtu pakënaqësi me mungesën e demokracisë brenda partive në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve.

⁵² Sipas ndryshimeve të 22 majit në Ligjin për Partitë Politike, materialet e palëvizshme të fushatës, përfshirë flamuj dhe postera, mund të vendoseshin vetëm brenda pesë metrave nga zyrat e fushatës së partive.

⁵³ Në 27 maj, PD-ja mbajti një miting në Tiranë ku morën pjesë disa mijëra njerëz. Pas këtij aktiviteti, MB-ja njoftoi se 73 persona kishin kërkuar ndihmë mjekësore për shkak të irritimeve në sy dhe lëkurë. Në 28 maj, Ministria e Shëndetësisë njoftoi se 140 persona kishin kërkuar ndihmën e parë, 14 prej të cilëve ishin shtruar në spital. Në 14 qershor, në qarkun Tiranë (Kavajë) tre mbështetës së PD-së u arrestuan se kishin sulmuar një anëtar të PS-së. Në 16 qershor, në qarkun Berat, drejtuesi i një dege vendore të LSI-së u sulmua nga tre persona që pretendohet se ishin të armatosur. Në të njëjtën ditë, në qarkun Lezhë, një mbështetës i LSI-së u kërcënua nga tre burra të armatosur. Në 18 qershor, në qarkun Durrës (Fushë-Krujë) një aktivist i LSI-së u shtrua në spital pasi u sulmua dhe u rrah nga persona të panjohur. Në 18 qershor, në qarkun Shkodër (Pukë), drejtuesit vendorë dhe të degës së të rinjve të LSI-së u kërcënuan nga koordinatori vendor i PS-së dhe, sipas informacioneve, më vonë nga policia. Veprimi i policisë u sqarua nga Bordi i Disiplinës para ditës së zgjedhjeve. Në 21 qershor, në qarkun Tiranë (Vorë), një mbështetës i LSI-së u qëllua me thikë para një bari, ndërsa po përpiqej të hynte me forcë pak përpara një takimi të përcaktuar më parë midis një zyrtari vendor dhe mbështetësve të PD-së. Në 23 qershor, një shpërthim ndodhi para zyrës vendore të LSI-së në Durrës duke shkaktuar dëme të vogla materiale dhe asnjë dëmtim në njerëz. Policia informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se të gjitha rastet e lartpërmendura ishin nën hetim.

⁵⁴ Në 7 qershor, në veçanti, LSI-ja u informua nga Kryetari socialist i Bashkisë së Vlorës se nuk mund të përdornin sheshin kryesor të qytetit për veprimtari fushate pasi ai i ishte dhënë një kandidati të PS-së që nga data 1 maj deri në 30 qershor.

⁵⁵ Kandidatët e disa partive të vogla, që kishin qenë në aleancë me PD-në në të shkuarën, u përfshinë në listat e kandidatëve të PD-së dhe e ri-orientuan fushatën e tyre në mbështetje të PD-së.

⁵⁶ Për shembull, mitingjet e PS-së në Durrës në 23 maj, në Fier në 26 maj, në Berat dhe Kukës në 5 dhe 6 qershor, përkatësisht. LSI-ja pati aktivitete në Kukës në 29 maj dhe në Dibër (Bulqizë) në 18 qershor me objektivin specifik zgjedhëset gra.

⁵⁷ MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it ndoqi profilet në Facebook dhe Twitter të partive kryesore politike dhe të kryetarëve të tyre. Z. Rama ishte më aktiv me 381 postime gjatë fushatës (z. Basha bëri 298 postime dhe z. Meta 201), me 1,094,172 ndjekës (z. Basha kishte 583,078 dhe LSI 208,777), dhe 2,405,167 angazhime (z. Basha kishte 1,116,494 dhe LSI 230,717). Numri i përgjithshëm i veprimeve në postime përfshin pëlqimet, komentet dhe ripostimet. Z. Meta nuk kishte një faqe zyrtare dhe publikonte në faqen e LSI-së.

PS-ja bëri fushatë më së shumti mbështetur në platformën për stabilitet dhe theksoi nevojën për vazhdimin e reformës administrative dhe gjyqësore. PD-ja theksoi zhvillimin ekonomik dhe pretendoi se qeveria e udhëhequr nga PS-ja kishte shkaktuar varfëri, emigrim masiv dhe kriminalitet e korrupsion të përhapur gjerësisht, në veçanti në lidhje me kultivimin e kanabisit. LSI-ja akuzoi PD-në dhe PS-në për marrëveshje të fshehtë midis tyre në dëm të garuesve të tjerë, duke pretenduar ekzistencën e pjesëve të papublikuara të marrëveshjes politike të 18 majit. Të gjitha partitë kryesore premuan paga më të larta, kushte më të mira jetese dhe një luftë më intensive ndaj krimit dhe korrupsionit, por propozimet për politika shpesh mungonin. PD-ja, LSI-ja dhe PS-ja ranë publikisht dakord lidhur me parimet për vazhdimin e procesit të integritetit të Shqipërisë në BE.

Gjatë fushatës, pati aludime të përhapura gjerësisht për blerje të votës.⁵⁸ Pas ditës së zgjedhjeve, si PD-ja edhe LSI-ja i përsëritën pretendimet e tyre pranë MVZ-së së OSBE/ODIHR-it se kishte ndodhur një operacion masiv, i përhapur gjerësisht, për blerjen e votës. Të dyja këto parti treguan disa raste konkrete, por në mungesë të provave të mjaftueshme konkluduese, nuk paraqitën ndonjë ankim ligjor kundër rezultateve. Megjithatë, ato iu përmbajtën deklaratës së tyre të palëkundur se shkalla e blerjes së votës ishte e lidhur me sasi të mëdha parash të vëna në dispozicion nga kultivimi kriminal i drogës.

Nevojiten përpjekje serioze për të trajtuar çështjen e vazhdueshme të blerjes së votës, si nëpërmjet një fushate për ndërgjegjësimin qytetar ashtu edhe nëpërmjet ndjekjes penale, me qëllim forcimin e besimit të procesit zgjedhor. Partitë politike mund të ndërmarrin një angazhim konkret dhe të mirëfilltë për të luftuar praktikën e blerjes së votës. Gjithashtu, një refuzim publik nga ana e politikanëve për të pranuar mbështetje financiare nga individë me të kaluar kriminale do të ndihmonte në ndërtimin e besimit të publikut në integritetin e zgjedhjeve.

Shumë bashkëbisedues të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it shprehën shqetësime mbi shpërdorimin e burimeve shtetërore⁵⁹ dhe presionin e lidhur me vendin e punës mbi punonjës të sektorit privat dhe publik, që kishte të bënte me veprimtaritë apo preferencat e tyre politike.⁶⁰ Ekziston shqetësimi që, në një mjedis me institucione të politizuara, preferencat zgjedhore të punonjësve të sektorit publik - një

⁵⁸ Ndonëse pretendimet ishin të përhapura gjerësisht në të gjithë vendin, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it mori konfirmim nga policia rajonale se kishte ndërmarrë veprime në rastet e mëposhtme: më 17 qershor, policia urdhëroi arrestimin e një individi që dyshohej se i kishte premtuar qytetarëve 10 000 lekë për çdo votë që do të jepej për një kandidat të caktuar në qarkun Shkodër. Më 23 qershor, në të njëjtin qark, policia ndaloi kryetarin e degës së një partie dhe një person tjetër të cilët ishin duke shpërndarë pako me ushqime me qëllimin e supozuar për të marrë vota. Në 24 qershor, dy burra u ndaluan nga policia në qarkun Shkodër duke ngarë një makinë me një sasi të madhe parash dhe një kopje të listës së zgjedhësve. Policia mori gjithashtu raportime për blerjen e votave ku përfshihej një kandidat i LSI-së në qarkun Shkodër dhe aktivistë të LSI-së në qarkun Fier.

⁵⁹ Për shembull, disa përfaqësues të partive informuan MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se, ndërkohë që bëhej fushata, bashkëshorti/ja e një kandidati/eje të LSI-së në Gjirokastrë përdorte subvencionet në bujqësi për të tërhequr zgjedhësit. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vërejti në qarqet Dibër, Fier dhe Korçë zyrtarë publikë të PD-së, PDIU-së dhe PS-së që bënë fushatë gjatë orarit të punës në mitingjet e partive përkatëse. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vëzhgoi gjithashtu një miting të LSI-së në Kukës ku morën pjesë punonjës të sektorit publik gjatë orarit të punës. Në 16 qershor, Kryeministri u bëri thirrje punonjësve të policëve dhe mësuesve të bënin fushatë për PS-në jashtë orarit zyrtar të punës, por kërkoi ndjesë për këtë gjë më vonë.

⁶⁰ Për shembull, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it u informua për tri raste të punonjësve publikë të OSHEE-së në qarkun Fier, të cilët u lëvizën në një post tjetër dhe/ose u ulën në detyrë për shkak se ishin mbështetës të LSI-së. Një përfaqësues partie në qarkun Fier i tha MVZ-së së OSBE/ODIHR-it se një kryetar bashkie u kishte bërë thirrje kompanive publike dhe private të largonin nga puna punonjësit që mbështesnin PD-në. Në qarqet Elbasan, Gjirokastrë, Korçë, Kukës dhe Tiranë, MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it vëzhgoi disa mitingje të PDIU-së, LSI-së dhe PS-së në të cilat pjesëmarrësit dukej se ishin të detyruar të merrnin pjesë. Në një rast në qarkun Korçë, pjesëmarrësit në miting i konfirmuan MVZ-së së OSBE/ODIHR-it se ishin stimuluar për të marrë pjesë në të nga mësuesit e fëmijëve të tyre. MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it mori dy raportime se PS-ja në Delvinë ushtronte presion mbi punonjësit për të marrë pjesë në një miting dhe mbante shënim emrat e punonjësve të administratës që ishin të pranishëm ose që mungonin në festën e përvjetorit të PS-së.

segment i shoqërisë i cënueshëm nga presionet - mund të kenë pasoja mbi mjetet e jetesës së individit dhe punësimin e tij/saj në të ardhmen.⁶¹

Autoritetet dhe partitë politike duhet të konsiderojnë marrjen e hapave më të vendosura për të siguruar që të mos ushtrohet presion mbi punonjësit e sektorit publik, aktivistët politikë dhe qytetarët e tjerë për të marrë pjesë në aktivitete të fushatës apo për të votuar në një mënyrë të caktuar. Çdo rast dhe pretendim për presion duhet të hetohet dhe ndiqet në mënyrë tërësore dhe të efektshme nga autoritetet përkatëse. Të gjitha rastet, përfshirë rezultatin e tyre, duhet të raportohen publikisht.

Pas marrëveshjes politike të 18 majit, qeveria ngriti një Task Forcë ministrore për të bashkërenduar veprimet qeveritare për të shmangur dhe, nëse do të ishte e nevojshme, për të ndëshkuar sjelljen e papërshtatshme të organeve administrative në procesin zgjedhor.⁶² Efektshmëria e Task Forcës u zbeh, gjithsesi, nga konfliktet kryesisht midis ministrave të caktuar nga PD-ja dhe përfaqësuesve të institucioneve shtetërore. Në disa raste, largimet dhe pezullimet nga puna të nëpunësve publikë nuk u bënë në përputhje me procedurat ligjore.⁶³ Disa prej këtyre largimeve nuk kishin lidhje të dukshme me procesin zgjedhor.⁶⁴ Kjo e ekspozoi procesin ndaj pretendimeve, kryesisht të LSI-së, se këto veprime ishin të motivuara politikisht.⁶⁵ Si hap pozitiv, Task Forca nxori një raport të hollësishëm të veprimtarisë së saj, si dhe ofroi një sërë rekomandimesh për përmirësimin e praktikave zgjedhore në të ardhmen.

Qeveria duhet të analizojë efektshmërinë e përpjekjeve të mëparshme për të luftuar shpërdorimin e burimeve shtetërore dhe presionet e lidhura me vendin e punës mbi zgjedhësit. Ajo duhet të marrë në konsideratë ngritjen e një organi transparent, të pavarur dhe përfshirës me detyrën dhe kompetencën e veprimit dhe të ndjekjes nëse vihet në dijeni për çështje të tilla në periudhën para dhe paszgjedhore. Kjo strukturë mund të ngrihet edhe në nivel vendor në një kohë të mjaftueshme përpara zgjedhjeve të radhës.

IX. FINANCIMI I FUSHATËS

Fushatat zgjedhore mund të financohen me fonde publike dhe private. Fondet publike u shpërndahen partive politike për veprimtaritë e tyre të rregullta, bazuar në rezultatet e tyre në zgjedhjet e fundit për Kuvendin. Të gjitha partive që garojnë në zgjedhje u jepen paraprakisht fonde shtesë për qëllim fushate, të cilat rillogariten pas zgjedhjeve.⁶⁶ Partitë që marrin më pak vota se sa duhet për të përfituar

⁶¹ Në paragrafin 5.4 të Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990 të OSBE-së, Shtetet pjesëmarrëse në OSBE angazhohen për "një ndarje të qartë midis shtetit dhe partive politike".

⁶² Task Forca zhvilloi pesë mbledhje gjithsej, gjatë periudhës 5 - 26 qershor.

⁶³ Për shembull, në 8 qershor, Ministri i Drejtësisë urdhëroi pezullimin e Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj ministrie. Sipas Ligjit për Shërbimin Civil, kjo kompetencë ushtrohet nga Departamenti i Administratës Publike. Në 2 qershor, Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes urdhëroi largimin nga detyra të Drejtorit të Përgjithshëm të Postës Shqiptare. Këtë kompetencë e ka Bordi Mbikëqyrës i Postës Shqiptare.

⁶⁴ Për shembull, në 13 qershor, Ministrja e Arsimit dhe Sportit urdhëroi largimin nga detyra të Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj ministrie. Në 30 qershor, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vendosi që nuk kishte baza për fillimin e procedurave disiplinore kundër Sekretarit të Përgjithshëm. Në 13 qershor, Ministri i Mirëqënies Sociale dhe Rinisë i kërkoi Departamentit të Administratës Publike të niste procedurat për largimin nga detyra të Sekretarit të Përgjithshëm të kësaj ministrie.

⁶⁵ Ministrat e LSI-së nuk ishin pjesë e Task Forcës.

⁶⁶ Partitë që morën mbi 0.5 për qind të votave të vlefshme në zgjedhjet e fundit për Kuvendin përfitojnë 95 për qind të fondeve, të ndara në përpjesëtim me numrin e votave të vlefshme që kanë marrë. Pjesa tjetër prej 5 për qind u shpërndahet partive që kanë marrë më pak se 0.5 për qind të votave dhe partive që nuk kanë marrë pjesë në zgjedhjet e fundit. Në 31 korrik, KQZ-ja shqyrtoi financimin e përfituar nga partitë që kishin marrë më shumë se 0.5 për qind të votave të vlefshme.

financim duhet ta kthejnë diferencën.⁶⁷ Buxheti total për financimin e fushatës ishte 65 milion lekë dhe u shpërnda nga KQZ-ja në 31 maj.⁶⁸ Kandidatët e pavarur nuk përfitojnë nga këto fonde publike.⁶⁹

Për qëllim fushate, garuesit zgjedhorë mund të marrin edhe dhurime private nga shtetas dhe persona juridikë shqiptarë, të marrin hua apo të përdorin fondet e tyre.⁷⁰ Asnjë dhurim nuk mund të kalojë shumën 1 milion lekë, përfshirë vlerën e barasvlershme për kontribute në natyrë. Të gjitha kontributet që kalojnë shumën 100.000 lekë duhet të bëhen nëpërmjet një llogarie të posaçme bankare. Transparenca e dhurimeve për fushatë mbeti e kufizuar për shkak të mungesës së detyrimit për bërjen e tyre publike gjatë fushatës.⁷¹

Kodi Zgjedhor përcakton një kufi për shpenzimet e fushatës, i cili për këto zgjedhje ishte 280 milion lekë.⁷² Pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve, KQZ-ja cakton ekspertë kontabël për auditimin e fondeve të fushatës për secilën parti politike që ka garuar në zgjedhje. Nuk ka afat ligjor për përfundimin e këtyre auditimeve. Raportet e audituesve publikohen nga KQZ-ja brenda 30 ditëve nga dorëzimi i tyre.

Ndryshimet në Ligjin për Partitë Politike të datës 22 maj synuan rritjen e transparencës dhe llogaridhënies për financimin e fushatës dhe trajtuan pjesërisht disa prej rekomandimeve të mëparshme të OSBE/ODIHR-it dhe Këshillit të Evropës. Masat e reja për uljen e kostove të fushatës u mirëpritën nga pjesa më e madhe e bashkëbiseduesve të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it. KQZ-ja u ngarkua me hartimin e udhëzimeve për përlllogaritjen e kostove të fushatës dhe caktimin e ekspertëve financiarë për monitorimin e fushatave. Gjithashtu, partitë që garuan në zgjedhje ishin të detyruara të bënin publike dhe të dorëzonin pranë KQZ-së një deklaratë financiare me të gjitha të ardhurat dhe shpenzimet e fushatës brenda 60 ditëve nga shpallja e rezultatit të zgjedhjeve.

Për të përmbushur këto kërkesa të reja, KQZ-ja caktoi ekspertë financiarë për secilën parti politike që garoi në zgjedhje, të cilët raportuan vëzhgimet e tyre të veprimtarive të fushatës dy herë para ditës së zgjedhjeve.⁷³ KQZ-ja i publikoi këto raporte dhe i përdori gjetjet e ekspertëve për të siguruar respektimin e rregullave të reja për fushatën.⁷⁴ Megjithatë, miratimi i vonë i ndryshimeve la pak kohë për zbatimin e tyre të plotë.⁷⁵ Metodologjia e përdorur nga ekspertët financiarë ishte e pazhvilluar, nuk u siguroa dot bashkëpunim me partitë politike dhe objekti i raporteve të ndërmjetme ishte i

⁶⁷ Ekspertët vunë në dukje efektin dekurajues të këtij rregulli për partitë e vogla dhe ato të reja. Një parti i tha MVZ-së së OSBE/ODIHR-it se ajo preferonte më shumë të mos i merrte fondet sesa të ishte e detyruar t'i kthente ato në rast se nuk do të arrinte të merrte një rezultat pozitiv në zgjedhje.

⁶⁸ Këto fonde u shpërndanë si më poshtë: PS - 28 milion lekë; PD - 20.8 milion lekë; LSI - 7 milion lekë; PR - 2 milion lekë; PDIU - 1.8 milion lekë; dhe partitë e tjera - midis 1.2 milion dhe 325,000 lekë.

⁶⁹ Paragrafi 130 i "Udhëzuesit mbi Rregulloret e Partive Politike" të Komisionit të Venecias dhe të OSBE/ODIHR-it rekomandon: "Në rastet kur partive politike të regjistruara u jepet ndihmë shtetërore... duhet të ketë një sistem mbështetjeje për kandidatët e pavarur që të garantojë se atyre u sigurohet një trajtim i barabartë në shpërndarjen e burimeve shtetërore".

⁷⁰ Kontributet anonime, dhurimet nga përfitues të fondeve dhe kontratave publike mbi një shumë të caktuar, si dhe dhurimet nga partnerët në projekte publike, kompanitë e mediave dhe debitorët e buxhetit të shtetit apo institucioneve shtetërore janë të ndaluara.

⁷¹ Neni 7.3 i UNCAC-ut parashikon që të merret në konsideratë marrja e "masave të duhura legjislative dhe administrative... për të rritur transparencën e financimit të kandidaturave për postet e zgjedhura publike dhe... të partive politike".

⁷² Sipas Kodit Zgjedhor, një parti politike nuk mund të shpenzojë më tepër se 10 herë sa shuma më e lartë që një garues në zgjedhje ka marrë nga fondet publike.

⁷³ Caktimi i ekspertëve u bë pas një thirrjeje të hapur për aplikime nga ekspertë në fushën e auditimit dhe financës.

⁷⁴ Për shembull, në 15 qershor, KQZ-ja i kërkoi kryetarit të bashkisë së Durrësit që t'i hiqte materialet e fushatës nga vendet e paautorizuara.

⁷⁵ Ndryshimet kërkonin që KQZ-ja të hartonte udhëzime për zbatimin e tyre brenda pesë ditëve nga miratimi i këtyre ndryshimeve dhe të caktonte ekspertët tre ditë më pas.

ndryshëm.⁷⁶ Rregullave që pasuan që kishin të bënin me fushatën u mungoi konsistenca dhe qartësia, dhe ato nuk siguruan transparencë të mirëfilltë të financimit të fushatës përpara ditës së zgjedhjeve.⁷⁷

Duhet të harmonizohen rregullat për financimin e fushatës dhe duhet të hartohen akte nënligjore me qëllim që të sigurohet një metodologji solide dhe qasje në informacionin e plotë mbi financimin e fushatës për ekspertët financiarë dhe zgjedhësit para dhe pas ditës së zgjedhjeve. Mund t'i kushtohet vëmendje përcaktimit të afateve për përfundimin e auditimeve paszgjedhore.

X. MEDIA

A. MJEDISI I MEDIAS

Mjedisi mediatic në Shqipëri është i gjallë, por dukshëm tejet i madh për mundësitë e kufizuara që ofron tregu i reklamës mediatike.⁷⁸ Për më tepër, sfidat që hasin shumë subjekte mediatike lidhur me qëndrueshmërinë financiare si dhe interesat ekonomike dhe politike të pronarëve të mediave, shpesh ndikojnë mbi raportimin e gazetarëve dhe mund të nxisin raste të vetë-censurimit. Televizioni (TV) është burimi kryesor i informacionit politik, ndërsa portalet online dhe media sociale po e zëvendësojnë me shpejtësi median e shkruar.

Numri dukshëm i lartë i subjekteve mediatike dhe aksesueshmëria e tyre siguroi informacion të bollshëm dhe të larmishëm mbi politikën dhe zgjedhjet, duke u mundësuar zgjedhësve të krahasojnë partitë dhe kandidatët dhe të bëjnë përzgjedhjen e tyre në ditën e votimit. Megjithatë, mbulimit të zgjedhjeve shpesh i mungoi analiza e thellë dhe ai u fokusua kryesisht te aktivitetet e partive dhe jo te bërja e ndonjë analize kritike.

B. KUADRI LIGJOR

Kushtetuta parashikon lirinë e shprehjes, lirinë e medias dhe të drejtën për informim, ndërkohë që ndalon censurimin e të gjitha mjeteve të komunikimit. Shpifja vijon të përbëjë vepër penale; megjithatë, që prej vitit 2012, ajo dënohet vetëm me gjobë.⁷⁹ Veprimtaria e medias audio-vizive jashtë periudhës zgjedhore rregullohet kryesisht nga Ligji për Median Audio-vizive, ndërsa media e shkruar është më së shumti e vetë-rregulluar.

Dispozitat penale për shpifjen duhet të shfuqizohen duke u dhënë përparësi zgjidhjeve juridike civile të hartuara për të rivendosur në vend reputacionin e dëmtuar.

Si zhvillim pozitiv, Autoriteti i Medias Audio-vizive (AMA) nisi monitorimin e mediave për mbulimin e veprimtarive të aktorëve politikë jashtë periudhës së fushatës dhe bëri publik buletin e

⁷⁶ Pjesa më e madhe e raporteve u kufizuan te vrojtimi i zyrave zgjedhore së partive, dhe pak prej tyre përmbanin vlerësime të kostove të këtyre zyrave dhe të aktiviteteve.

⁷⁷ Ndërkohë që Kodi Zgjedhor përcakton një kufi të barabartë për shpenzimet për partitë politike, ndryshimet i dhanë të drejtën KQZ-së të përcaktonte një kufi shpenzimi për çdo "fushatë zgjedhore"; kuptimi i kësaj dispozite mbeti i paqartë. Termi "zyrë zgjedhore" nuk ishte i përkufizuar në legjislacion. KQZ-ja nxori një udhëzim që kufizonte numrin e zyrave zgjedhore në një për "lagje" por as ky term nuk ishte i përkufizuar, gjë që çoi në interpretime të ndryshme.

⁷⁸ Në vend operojnë 75 kanale TV, përfshirë 3 kanale kombëtare, rreth 100 stacione radiofonike dhe 20 gazeta të përditshme.

⁷⁹ Paragrafi 47 i Komentit të Përgjithshëm 34 të vitit 2011 të ICCPR-së kërkon që "ligjet për shpifjen të hartohen me kujdes për të siguruar që ato të mos shërbejnë, në praktikë, për të shtypur lirinë e shprehjes". Në vitin 2015, Përfaqësuesja e OSBE-së për Lirinë e Medias (RFoM) [u bëri thirrje autoriteteve](#) të "marrin në konsideratë shfuqizimin e plotë të kriminalizimit të shpifjes".

saj periodik, i cili përfshiu raporte mbi ecurinë ekonomike të subjekteve mediatike.⁸⁰ Gjithashtu, pronësia e medias është formalisht transparente dhe e aksesueshme nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit, dhe informacioni përkatës për to është i disponueshëm online.

Pasqyrimi i fushatës në mediat audio-vizive rregullohet me hollësi nga Kodi Zgjedhor, i cili parashikon akses proporcional për të gjithë garuesit në zgjedhje në edicionet e lajmeve dhe programet informative të këtyre mediave, si dhe mundësinë për fushatë në mënyrë proporcionale dhe pa pagesë në transmetuesin publik.⁸¹

Në 19 prill, KQZ-ja ngriti Bordin e Monitorimit të Medias (BMM) për të monitoruar fushatën zgjedhore në mediat audio-vizive publike dhe private.⁸² Vonesa në emërimet shkaktoi probleme në trajnimin e personelit monitorues në nivel qendror. Mungesa e pajisjeve dhe e personelit të trajnuar penguan seriozisht eficiencën e monitorimit në nivel vendor. Për më tepër, metodologjia e monitorimit vazhdon të mos përfshijë tonin e mbulimit të garuesve në zgjedhje.

Në praktikë, subjektet mediatike e patën të vështirë të siguronin një mbulim proporcional të garuesve për shkak të intensitetit të ndryshëm të aktiviteteve të fushatës nga ana e partive të vogla, gjë e cila u pranua edhe nga BMM-ja. Kjo e fundit i paraqiti KQZ-së 28 raporte ditore, 4 javore dhe një përfundimtar, duke propozuar që 27 media kombëtare dhe vendore gjithsej të kompensojnë minutazhin e mangët të mbulimit dhe që 7 media të gjobiteshin. KQZ-ja votoi kundër të gjitha propozimeve për vendosjen e gjobave, ndërkohë që miratoi gjithmonë kompensimin e minutazhit të mbulimit të partive, duke u kërkuar operatorëve mediatikë që ta korigjonin minutazhin e mangët të mbulimit brenda 48 orëve. Media i përmbushi në masë të madhe këto kërkesa. Kështu, u vendos një bashkëpunim pozitiv midis KQZ-së, BMM-së dhe subjekteve mediatike.

Marrëveshja politike e 18 majit prodhoi një situatë të paqartë në kuadrin ligjor për median. Ndryshimet e minutës së fundit në Ligjin për Partitë Politike që rrodhën nga marrëveshja, sipas të cilave në këto zgjedhje ndalohej reklama politike me pagesë gjatë fushatës, ranë ndesh me Kodin Zgjedhor. Subjektet mediatike private kombëtare dhe vendore i dërguan dy letra KQZ-së ku shpreheshin se do të zbatonin Kodin Zgjedhor dhe jo ndryshimet e ligjit, të cilat i konsideronin si jokushtetuese. KQZ-ja nuk mori asnjë masë për të qartësuar kuadrin ligjor, dhe nëntë kanale televizive private transmetuan reklama politike me pagesë gjatë fushatës për disa parti.

C. GJETJET E MONITORIMIT TË MEDIAS

Rezultatet e monitorimit nga MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it treguan se media u ofroi garuesve mundësinë e pjesëmarrjes në debate dhe programe *talk-shows*.⁸³ Në të gjitha kanalet TV të

⁸⁰ [Buletini](#) i parë mbuloi gjashtëmujorin e parë të vitit 2016.

⁸¹ Transmetuesve u kërkohet që t'u japin minutazh të barabartë për pasqyrim të fushatës partive që kanë më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend. Çdo partie tjetër parlamentare i jepet gjysma e kësaj kohe, ndërsa minutazhi i mbulimit për partitë jo-parlamentare që garojnë në zgjedhje është në diskrecion të editorëve dhe nuk mund të kalojë minutazhin që u jepet partive të vogla parlamentare. Gjithashtu, sipas vendimit të KQZ-së, PS-së dhe PD-së (me më shumë se 20 për qind të vendeve në Kuvend) iu dhanë nga 60 minuta falas secilës; LSI-së, PDIU-së dhe PKD-së (me më pak se 20 për qind të vendeve në Kuvend) iu dhanë nga 30 minuta falas secilës; dhe secilës prej 11 partive të tjera garuese joparlamentare iu dha 10 minuta falas në transmetuesin publik.

⁸² BMM-ja përbëhet nga shtatë anëtarë. Secili anëtar i KQZ-së emëron një anëtar të BMM-së nga lista të propozuara nga organizata jofitimprurëse kombëtare në fushën e medias. Që nga 26 maji, BMM-ja filloi monitorimin e 13 operatorëve audio-vizivë që transmetonin nga Tirana dhe të 25 operatorëve që transmetonin nga 8 qarqe.

⁸³ MVZ-ja e OSBE/ODIHR-it monitoroi një spektër të gjerë subjektësh mediatike me analiza sasiore dhe cilësore të mbulimit politik të fushatës prej tyre gjatë transmetimeve në fashën më të ndjekur orare (nga ora 18:00 deri në orën 24:00) për pesë kanale TV (transmetuesi publik *RTSH* dhe katër kanale private: *ABC News*, *Top Channel*, *TV Klan* dhe *Vizion Plus*), një gazetë të përditshme (*Panorama*) dhe tre portale online (*balkanweb.com*, *gazetatema.net* dhe *syri.net*).

monitoruara, raportimi i fushatës u përqendrua më së shumti në veprimtaritë e tri partive kryesore, ndërkohë që nuk u zhvillua asnjë debat midis kryetarëve të partive të mëdha. Megjithatë, pasqyrimi i aktiviteteve të fushatës së partive kryesore u bë përgjithësisht nëpërmjet filmimeve të përgatitura dhe të dërguara medias nga vetë partitë. Për më tepër, këto filmime nuk u identifikuan si të tilla në mënyrë konsistente dhe të qartë në të gjitha kanalet TV private. Pavarësisht nga rekomandime të mëparshme të OSBE/ODIHR-it, neni 84.1 i Kodit Zgjedhor lejon ende që filmime të regjistruara më parë që përgatiten nga partitë të transmetohen gjatë edicionit të lajmeve, gjë që çon në zbehjen e ndarjes midis përmbajtjes editoriale dhe reklamës politike. Kjo gjë bie ndesh me angazhimet e OSBE-së dhe standardet e Këshillit të Evropës.⁸⁴

Për të siguruar pavarësi editoriale të medias, duhet konsideruar shfuqizimi i nenit 84.1 të Kodit Zgjedhor dhe ndalimi në mënyrë të qartë i transmetimi në lajme të reklamave politike.

Si zhvillim inkurajues, transmetuesi publik Radio Televizioni Shqiptar (RTSH) njoftoi në 23 maj se nuk do të pranonte asnjë filmim të regjistruar nga vetë partitë. RTSH-ja u ofroi të gjithë garuesve minutazh falas dhe tregoi qartësisht një qasje të balancuar në raportimin e fushatës në edicionet e saj të lajmeve dhe programet informative, duke i dhënë 25 për qind të minutazhit të pasqyrimin PD-së, 24 për qind PS-së dhe 19 për qind LSI-së; toni i pasqyrimin ishte më së shumti neutral ose pozitiv. Megjithatë, ndikimi i RTSH-së në ndërgjegjësimin e publikut për fushatën ishte i kufizuar për shkak të audiencës së saj të ulët.

Ndërkohë që një mbulim i ngjashëm i balancuar u vu re te *Vizion Plus* (ku PD-së iu dha 34 për qind, PS-së 36 për qind dhe LSI-së 17 për qind), *ABC News* i dha 37 për qind të minutazhit PD-së, 28 për qind PS-së dhe 21 për qind LSI-së; toni i pasqyrimin të fushatës ishte përgjithësisht neutral ose pozitiv. Një mbulim disi më kritik i fushatës u vu re në *TV Klan* (për të gjitha partitë kryesore), i cili i dha 42 për qind të mbulimit PS-së, 24 për qind PD-së dhe 17 për qind LSI-së. Një pasqyrim i ngjashëm i fushatës u vu re në *Top Channel*, i cili u dha 42, 33 dhe 16 për qind të minutazhit të mbulimit përkatësisht PS-së, PD-së dhe LSI-së; por toni i mbulimit të PD-së ishte pjesërisht negativ.⁸⁵ Në 24 dhe 25 qershor, gjatë periudhës së heshtjes zgjedhore, disa kanale TV transmetuan një konferencë për shtyp të LSI-së, por as BMM-ja dhe as KQZ-ja nuk morën ndonjë masë kundër shkeljes.

XI. PJESËMARRJA E PAKICAVE KOMBËTARE

Kushtetuta parashikon të drejta të plota politike, civile dhe sociale për pakicat kombëtare dhe garanton të drejtën e votës dhe të drejtën për të kandiduar në zgjedhje për të gjithë qytetarët, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, racore, fetare apo gjuhësore. Përsa i përket proceseve zgjedhore, shoqëria shqiptare konsiderohet gjerësisht të jetë e mirë-integruar, dhe anëtarët e pakicave kombëtare kandiduan si në partitë e pakicave ashtu edhe në ato të popullsisë shumicë.

Fushata në gjuhët e pakicave kombëtare është e lejueshme. Nuk u vërejtën incidente në fushatat publike në gjuhët greke dhe maqedonase. Asnjë kandidat i pakicave kombëtare nuk i shprehu

⁸⁴ Shih paragrafin 9.1 të Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990 dhe paragrafin 26 të Dokumentit të Moskës të vitit 1991. Shih edhe paragrafin I.3 të Rekomandimit të Këshillit të Evropës CM/Rec (2007)15 që thotë: "kuadrot rregullatore për pasqyrimin e zgjedhjeve në media duhet të respektojnë pavarësinë editoriale të medias".

⁸⁵ Krahasuar me mediat e tjera, gazeta *Panorama* favorizoi PD-në (40 për qind të hapësirës së dedikuar pasqyrimin të fushatës) në dëm të PS-së dhe LSI-së (përkatësisht 32 dhe 20 për qind), me një ton kryesisht neutral dhe pozitiv për të gjithë garuesit. Ndër portalet online të monitoruara, *balkanweb.com* bëri një pasqyrim të balancuar për të gjithë garuesit e mëdhenj, ndërsa *gazetatema.net* pasqyroi në mënyrë të barabartë PD-në dhe PS-në (37 për qind secila) por 44 për qind e informacionit për PD-në pati ton negativ. Nga ana tjetër, *syri.net* ishte në favor të PD-së (47 për qind, me një pasqyrim përgjithësisht me ton neutral dhe pozitiv), duke i dhënë 34 për qind PS-së (ku një e treta e përmbajtjes pati ton negativ).

shqetësim MVZ-së së OSBE/ODIHR-it që nuk kishte qenë në gjendje të përdorte gjuhën e tij/saj, përfshirë në median audio-vizive.⁸⁶ Nuk u vërejt asnjë incident domethënës që të tregonte tension mbi baza etnike apo diskriminim ndaj komuniteteve të pakicave kombëtare. Toni i përgjithshëm i debatit lidhur me çështje të pakicave kombëtare u duk tolerant.

Disa zyrtarë e informuan MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se zgjedhës nga komuniteti Rom ndeshin ende pengesa praktike që lidhen me regjistrimin e zgjedhësve për shkak të një sërë faktorësh, përfshirë mungesën e dokumenteve zyrtare dhe mospasjen e një vendbanimi të qendrueshëm. Një numër bashkëbiseduesish pranuan se përpjekjet për blerjen e votave në zona të disavantazuara ekonomikisht mbeten një problem. Ndonëse ky fenomen nuk haset vetëm në këto komunitete, ai prek në veçanti pakicat kombëtare Rome dhe Egjiptiane.⁸⁷

Çështje që lidhen me pakicat kombëtare ishin të pranishme në një masë të caktuar në fushtatat e partive të mëdha, të cilat kërkuan të tërhiqnin zgjedhës nga këto komunitete. Secila nga partitë më të mëdha etnike greke dhe maqedonase zgjodhi të mbështesë partitë e popullsisë shumicë përkundër kandidimit veçmas.⁸⁸ Tek komunitetet Rome dhe Egjiptiane mbetet i lartë zhgënjimi në lidhje me procesin zgjedhor.⁸⁹

Fletët e votimit ishin të disponueshme vetëm në gjuhën shqipe; megjithatë, KQZ-ja prodhoi postera dhe fletëpalosje informuese në gjuhët greke, maqedonase, rome, serbe dhe vllehe/arumune. Pati një projekt në shkallë të vogël për edukimin e zgjedhësve në nivel personal për të luftuar shitjen e votës në komunitetet Rome dhe Egjiptiane, duke trajtuar kështu pjesërisht një rekomandim të mëparshëm të OSBE/ODIHR-it.⁹⁰

KQZ-ja dhe aktorë të tjerë mund të organizojnë programe edhe më përfshirëse për edukimin e zgjedhësve në nivel personal të përshtatura sipas nevojave të pakicave kombëtare Rome dhe Egjiptiane.

XII. ANKIMET DHE APELIMET

Kodi Zgjedhor parashikon procedura për ankimin administrativ kundër vendimeve të KZAZ-së dhe apelimin gjyqësor kundër vendimeve të KQZ-së. Megjithatë, përgjegjësia për ankesat që lidhen me shkeljet në fushatë është e paqartë.⁹¹ Përfaqësuesit e partive politike e informuan MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se parapëlqenin t'i bënin publike shqetësimet e tyre në media, për shkak të besimit të ulët në efektshmërinë e mekanizmave formalë të ankimit. Përpara ditës së zgjedhjeve u paraqitën

⁸⁶ Partia MEGA, e vetmja parti e pakicave kombëtare në fletën e votimit që përfaqëson një pakicë kombëtare me gjuhë amëtare të ndryshme nga shqipja, e përdori gjysmën e minutazhit të saj falas në RTSH në gjuhën shqipe dhe gjysmën tjetër në gjuhën greke.

⁸⁷ Një përfaqësues nga një parti politike Rome, edhe pse nuk kandidonte në këto zgjedhje, theksoi se po shpenzonte shumë kohë për t'i edukuar zgjedhësit që ta luftonin këtë fenomen.

⁸⁸ PBDNJ-ja bashkoi forcat me PD-në: kryetari i PBDNJ-së pranoi pozicionimin në vendet e larta të listës së PD-së në Vlorë, dhe një anëtar tjetër i PBDNJ-së u përfshi në listën e PD-së në Korçë. Aleanca Maqedonase për Integrim Evropian vendosi të mbështesë LSI-në me një kandidat në listat e saj në Korçë.

⁸⁹ Arsyet e cituara nga bashkëbiseduesit e MVZ-së së OSBE/ODIHR-it përfshinë premtime të perceptuara si të pambajtura të bëra nga kandidatët gjatë fushatave të mëparshme si dhe mungesë interesi për shkak të çështjeve më të rëndësishme që lidhen me jetën e përditshme me të cilat duhet marrë.

⁹⁰ Projekti u mbështet nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri. Ai u përqendrua në metodologjinë e "trajnitimit të trajnuesve", me anë të të cilit u trajnuan një numër i kufizuar studentësh dhe ky informacion iu përcoll më pas të tjerëve. Një drejtues i një partie rome informoi MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se ky ishte një fillim i mirë, por i pamjaftueshëm në shtrirjen e tij.

⁹¹ Sipas Kodit Zgjedhor (neni 33), KZAZ-ja mund të regjistrojë ankesa nga garuesit në zonë dhe t'i verifikojë ato. Disa KZAZ e informuan MVZ-në e OSBE/ODIHR-it se do të trajtonin çdo ankesë që lidhej me shkelje të fushatës, ndërsa disa të tjera besonin se vetëm KQZ-ja ishte e autorizuar për ta bërë këtë gjë.

një numër i paktë ankimesh në lidhje me fushatën, të cilat shpesh iu drejtuan në të njëjtën kohë organeve të ndryshme.⁹² Ndërkohë që KQZ-ja iu ktheu përgjigje këtyre kërkesave, nuk ndodhi gjithmonë e njëjta gjë me organet e tjera.⁹³

Garuesit zgjedhorë mund t'i ankimojnë vendimet e KZAZ-së në KQZ. Përpara ditës së zgjedhjeve nuk u paraqit asnjë ankimi i tillë. Vëzhguesit vendorë mund të ankimojnë vendimet e KQZ-së dhe të KZAZ-së që lidhen me akreditimin e tyre. Vendimet e KQZ-së për miratimin e rezultateve të zgjedhjeve ankimohen fillimisht në vetë KQZ. Kjo e fundit duhet të marrë një vendim për ankimin e rezultateve të zgjedhjeve brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës ankimore, por nuk ka një afat të përcaktuar qartë për llojet e tjera të ankimeve.⁹⁴ Procedura e ankimit administrativ në KQZ është e shtjelluar në mënyrë të hollësishme dhe përfshin caktimin e një relatori dhe zhvillimin e një seance për verifikimin e pranueshmërisë për çdo kërkesë ankimore.⁹⁵

Ligji duhet të përcaktojë qartë përgjegjësitë për ankimet përpara ditës së zgjedhjeve, sipas objektit të tyre të kërkesës, me qëllim që të sigurohet zgjidhje efektive. Procedurat e ankimit mund të thjeshtohen dhe afatet për zgjidhjen e ankimeve mund të shkurtohen.

Vendimet e KQZ-së dhe mosmarrja prej saj e vendimeve mund të apelojnë në Kolegjin Zgjedhor vetëm nga garuesit në zgjedhje.⁹⁶ Kufizimi i legjitimitetit për paraqitjen e apelineve mund t'i lërë palët e prekura pa një mundësi zgjidhjeje ligjore.⁹⁷ Përpara ditës së zgjedhjeve u paraqit një numër i vogël apelimesh në Kolegjin Zgjedhor, të lidhura kryesisht me regjistrimin e kandidatëve.⁹⁸ Kolegji Zgjedhor e respektoi afatin 10-ditor për shqyrtimin e apelineve, por jo gjithmonë vendimet e tij u zbardhën me shkrim brenda periudhës së kërkuar 3-ditore.⁹⁹ Të drejtat procedurale të palëve u respektuan dhe vendimet u arsyetuan, ndonëse jo gjithmonë në mënyrë konsistente.¹⁰⁰ Vendimet e Kolegjit Zgjedhor janë të formës së prerë.¹⁰¹

⁹² Për shembull, PD-ja në Dibër u ankua në 6 qershor pranë KZAZ-së, kryetarit të bashkisë dhe policisë për mosrespektimin nga PDIU-ja të rregullave të fushatës. Në Gjirokastrë, PD-ja u ankua në 12 qershor në polici dhe në KZAZ për shkelje të rregullave të fushatës nga PS-ja dhe LSI-ja.

⁹³ Në Dibër, PD-ja u ankua në mënyrë të përsëritur pranë kryetarit të bashkisë dhe KZAZ-së se ankesat e saj nuk ishin shqyrtuar.

⁹⁴ Sipas KQZ-së, afati 10 ditor zbatohet për të gjitha ankimet. Seksioni II.3.3.g i Kodit të Praktikave të Mira në Çështje Zgjedhore i Komisionit të Venecias rekomandon që "limitet kohore për paraqitjen dhe marrjen e vendimit mbi ankimet duhet të jetë të shkurtra (në shkallën e parë, tre deri në pesë ditë për secilën)".

⁹⁵ Seksioni II.3.3.b i Kodit të Praktikave të Mira në Çështje Zgjedhore i Komisionit të Venecias rekomandon që "procedura duhet të jetë e thjeshtë dhe pa formalizma, veçanërisht në lidhje me pranueshmërinë e apelineve".

⁹⁶ Kolegji Zgjedhor përbëhet nga tetë gjyqtarë të zgjedhur me short mes gjyqtarëve të gjykatave të apelit të Shqipërisë për katër vjet. Apelimet shqyrtohen nga një panel prej pesë gjyqtarësh, të zgjedhur me short për secilën çështje. Kolegji Zgjedhor aktual u ngrit në dhjetor 2016 dhe përfshin një gjyqtare grua.

⁹⁷ Paragrafi 5.10 i Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990 thotë: "... çdokush duhet të ketë një mjet efektiv zgjidhjeje kundër vendimeve administrative, për të garantuar respektim të të drejtave themelore dhe për të siguruar integritet ligjor". Seksioni 99 i Relacionit të Kodit të Praktikave të Mira në Çështje Zgjedhore të vitit 2002 i Komisionit të Venecias thotë që: "legjitimiteti për apelimet [zgjedhore] duhet të garantohet në një shkallë sa më të gjerë. Mundësia e paraqitjes së një apeli... duhet të jetë e hapur për çdo zgjedhës në atë zonë".

⁹⁸ Deri në ditën e zgjedhjeve, Kolegji Zgjedhor shqyrtoi nëntë apeline. Për tre prej tyre Kolegji vendosi se ato ishin jashtë juridiksionit të tij (çështjet lidheshin me heqjen e mandatit të deputetit sipas Ligjit për Dekriminalizimin dhe me pagën e sekretarit të KZAZ-së), ndërsa pesë të tjera kishin të bënin me regjistrimin e kandidatëve. Një apelim nga LSI-ja kishte të bënte me të drejtën e propozimit të anëtarëve të grupeve të numërimit.

⁹⁹ Kolegji Zgjedhor mbështetet te Gjykata e Apelit Tiranë për ndihmë administrative.

¹⁰⁰ Kolegji Zgjedhor vendosi se një parti politike që u regjistrua për zgjedhjet por nuk paraqiti lista kandidatësh nuk kishte interes ligjor në kundërshtimin e regjistrimit të listave të PD-së dhe PR-së, duke shmangur shqyrtimin gjyqësor të regjistrimeve që u bënë si rrjedhojë e marrëveshjes politike të 18 majit. Një kandidat i pavarur, i cili pretendoi se edhe ai mund të regjistrohej në bazë të marrëveshjes politike, nuk u regjistrua. Kolegji vendosi që PDIU-ja duhet të konsiderohej si pjesë e opozitës për efekt të propozimeve për antarësi në grupet e numërimit, ndërkohë që në vitin 2015 ai kishte vendosur që PDIU-ja duhej konsideruar si pjesë e shumicës qeverisëse.

¹⁰¹ Kushtetuta i jep Gjykatës Kushtetuese juridiksion mbi shkeljet e të drejtave dhe lirive kushtetuese, por në praktikë ky juridiksion nuk ushtrohet në lidhje me të drejtat zgjedhore.

Partive politike dhe zgjedhësve të cilëve u preken drejtpërdrejt të drejtat apo interesat nga akte të administratës zgjedhore duhet t'u njihet legjitimitimi për t'i apeluar këto akte në një organ gjyqësor. Afatet ligjore për shqyrtimin e apelimit mund të shkurtohen.

XIII. VËZHGIMI I ZGJEDHJEVE

Kodi Zgjedhor parashikon vëzhgim nga përfaqësues vendorë dhe ndërkombëtarë të të gjitha fazave të procesit. Partitë garuese dhe organizatat e vëzhguesve vendorë dhe ndërkombëtarë kanë të drejtën të caktojnë vëzhgues në çdo KZAZ, KQV dhe VNV; megjithatë, vetëm garuesit mund të caktojnë vëzhgues në çdo tryezë numërimi. Partitë parlamentare mund të caktojnë përfaqësues të përhershëm në KQZ, ndërsa partitë e tjera kanë të drejtën të caktojnë përfaqësues për të ndjekur mbledhjet e KQZ-së vetëm gjatë periudhës zgjedhore.

Ndryshe nga vëzhguesit e partive politike, ligji nuk i detyron KQV-të dhe KZAZ-të t'u japin vëzhguesve vendorë apo ndërkombëtarë procesverbalet e mbylljes së qendrës së votimit dhe tabelat e rezultateve, duke e kufizuar në këtë mënyrë aftësinë e tyre për të shqyrtuar në mënyrë të efektshme procedurat e numërimit dhe nxjerrjes së rezultatit.¹⁰² Afër ditës së zgjedhjeve, KQZ-ja i detyroi KZAZ-të të shfaqnin publikisht tabelat e rezultateve në VNV, në përputhje me një rekomandim të mëparshëm të OSBE/ODIHR-it. Megjithatë, rezultatet nuk u afishuan në shumë VNV të vëzhguara nga MNVZ-ja, në kundërshtim me vendimin e KQZ-së.

Për të forcuar transparencën, ligji duhet të garantojë të drejta të njëjta për të gjithë vëzhguesit dhe të përcaktojë qartë se të gjithë vëzhguesit kanë të drejtë të marrin kopje të tabelës së rezultateve.

Autoritetet ftuan disa grupe vëzhguesish ndërkombëtarë. Në mënyrë përfshirëse, KQZ-ja akreditoi gjithsej 541 vëzhgues ndërkombëtarë dhe 3,731 vëzhgues vendorë.

XIV. DITA E ZGJEDHJEVE

Dita e zgjedhjeve u zhvillua në një mjedis me aludime për blerje vote dhe incidente të lidhura me fushatën në qendra votimi dhe presione të pretenduara ndaj zgjedhësve, të cilat u raportuan dhe u amplifikuan nga media. Për shkak të pjesëmarrjes së ulët por pa bazë ligjore, njëzetë minuta para mbylljes së votimit KQZ-ja njoftoi shtyrjen me një orë të votimit për të mundësuar votimin e më shumë zgjedhësve. Ky ndryshim rezultoi në një zbatim jo të njëtrajtshëm të vendimit dhe shkaktoi pështjellim në qendrat e votimit. Kjo bëri që disa prej tyre të mbylleshin përpara orarit të ri, gjë që u mohoi disa zgjedhësve mundësinë për të hedhur votën e tyre. KQZ-ja njoftoi se pjesëmarrja e zgjedhësve në votim ishte 46.8 për qind.¹⁰³

Për të siguruar zbatim të njëtrajtshëm të rregullave dhe trajtim të barabartë të zgjedhësve, ndryshimet në rregullat e votimit nuk duhet të bëhen ditën e zgjedhjeve, përveç se në rastet e një force madhore.

¹⁰² Neni 10 i UNCAC të vitit 2003 shprehet që secili Shtet Palë duhet të "marrë masa të tilla sipas nevojës për forcimin e transparencës në administratën publike, përfshirë në lidhje me organizimin, funksionimin dhe proceset vendimmarrëse". Seksioni I.3.2.xiii Kodit të Praktikës së Mirë në Çështje Zgjedhore të vitit 2002 i Komisionit të Venecias shprehet që "numërimi duhet të jetë transparent. Vëzhguesit, përfaqësuesit e kandidatëve dhe media duhet të lejohen të jenë të pranishëm. Këta persona duhet të kenë gjithashtu qasje në të dhëna".

¹⁰³ KQZ-ja njoftoi pjesëmarrjen paraprake në zgjedhje periodikisht në orën 10:30 (12 për qind), 13:00 (25 për qind), 16:00 (35 për qind), dhe 23:50 (45 për qind).

Vëzhguesit ishin në gjendje ta ndiqnin procesin pa kufizime në pothuajse të gjitha qendrat e votimit të vëzhguara dhe u siguria, përgjithësisht, transparenca e procesit.¹⁰⁴ Vëzhguesit e partive ishin të pranishëm në 95 për qind të qendrave të vëzhguara, dhe ishin në shkallën më të madhe nga PD-ja, LSI-ja dhe PS-ja. Vëzhguesit vendorë ishin të pranishëm në vetëm 17 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara gjatë hapjes dhe votimit; megjithatë, ata ishin të pranishëm në mbi dy të tretat e VNV-ve të vëzhguara. Ndonëse prania e vëzhguesve e shtoi në përgjithësi transparençën, në disa raste vëzhguesit e partive ndërhyjnë në proces.

A. HAPJA DHE VOTIMI

Hapja u vlerësua negativisht në 16 për qind të vëzhgimeve, çka është domethënëse. Pjesa më e madhe e qendrave të votimit të vëzhguara u hapën vonë (63 për qind), kryesisht për shkak të mungesës së komisionerëve apo njohurisë së dobët mbi procedurat nga ana e tyre, gjë që tregon për mungesën e trajnimit të duhur. Vonesa në hapje ishte, zakonisht, midis 10 dhe 30 minutash. Probleme të ndryshme procedurale u vërejtën në 16 për qind të vëzhgimeve, përfshirë mungesën e disa materialeve zgjedhore në qendrat e votimit dhe mospërmbushjen e detyrimit nga KQV-të për t'u treguar vëzhguesve kutitë e zbrazëta të votimit përpara fillimit të votimit. Njerëz të paautorizuar ishin të pranishëm në 10 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara dhe MNVZ-ja vërejti ndërhyrje në proces nga vëzhgues të partive në 8 për qind të vëzhgimeve.

MNVZ-ja e vlerësoi votimin negativisht në 7 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara, kryesisht për shkak të mosmbajtjes së rregullit të duhur të radhave, parregullsive procedurale dhe ndikimit të parregullt të vëzhguesve të partive në proces. U vërejtën gjithashtu disa shkelje serioze procedurale, përfshirë kontrollin jokonsistent të zgjedhësve për shenjën e bojës (25 për qind të vëzhgimeve) dhe zbatim jokonsistent të vendosjes së shenjës së bojës të zgjedhësit pasi këta të fundit merrnin fletën e votimit (12 për qind); të dyja këto procedura janë elemente kyçe mbrojtës kundër votimit të shumëfishtë. Nënshkrime në dukje identike u vërejtën në 5 për qind të vëzhgimeve. Votimi në vend të një zgjedhësi tjetër u vërejt në 5 për qind të vëzhgimeve dhe raste të votimit në grup u vërejtën në 11 për qind të vëzhgimeve. Komisionerët nuk e respektuan procedurën në pjesën më të madhe të rasteve kur u vërejt votim i asistuar dhe, në kundërshtim me ligjin, i njëjti person u lejua të asistonte disa zgjedhës në 2 për qind të vëzhgimeve.¹⁰⁵

Fshehtësia e votës mund të ishte kompromentuar në 4 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara për arsye se mjediset e votimit ishin të papërshtatshme për zhvillimin e procesit të votimit (4 për qind) ose për shkak të mbipopullimit (6 për qind). Më tej, fshehtësia nuk u siguria gjithmonë në 10 për qind të vëzhgimeve pasi zgjedhësit i shenjën fletët e votimit jashtë dhomës së fshehtë të votimit, dhe zgjedhësit nuk e palosën fletën e votimit siç e kërkon ligji në 6 për qind të vëzhgimeve. Pati shqetësime në lidhje me konfigurimin e fletës së votimit, e cila vazhdon të ketë një *barkod* me një numër serial në sekuençë pasuese, gjë që krijon mundësinë teknike që të bëhet lidhje midis fletës së shënuar të votimit dhe një zgjedhësi specifik.

Tension apo trazirë u konstatua në 4 për qind të qendrave të votimit të vëzhguara nga MNVZ-ja. Grupe aktivistësh partiakë të ndodhur në afërsi të qendrave të votimit të vëzhguara shpesh u duk se udhëzonin zgjedhësit se për kë të votonin. Në 5 për qind të vëzhgimeve, MNVZ-ja vuri re individë që përpiqeshin të ndikonin zgjedhësit për të votuar për një parti të caktuar brenda qendrës së votimit.

¹⁰⁴ Në KZAZ-në 30 (Tiranë), një prej ekipeve të vëzhguesve të MNVZ-së u nxorr jashtë VNV-së me arsyetimin se vëzhguesit nuk kishin të drejtë të ishin të pranishëm në ato mjedise. Neni 7.1 i Kodit Zgjedhor u njeh vëzhguesve të drejtën të vëzhgojnë pa pengesë të gjitha aspektet e zhvillimit të zgjedhjeve dhe të gjitha fazat e procesit zgjedhor.

¹⁰⁵ Në pjesën më të madhe të rasteve të vëzhguara nga MNVZ-ja, zgjedhësit që asistonin zgjedhës të tjerë nuk nënshkruan ndonjë deklaratë ku të shpreheshin se do të zbatonin vullnetin e zgjedhësit. Në disa raste, ishin komisionerët ata që asistuan zgjedhësit. Të dyja këto dukuri bien ndesh me ligjin.

Vëzhguesit e MNVZ-së vërejtën shumë raste kur vëzhguesit e partive mbanin shënim ata që kishin votuar duke regjistruar numrat rendorë që ata kishin në listën e zgjedhësve. Ky proces u ndihmua nga komisionerët, të cilët e lexonin me zë të lartë numrin rendor të zgjedhësit.¹⁰⁶

Shteti duhet të garantojë të drejtën për të bërë një zgjedhje të lirë dhe të fshehtë. Duhet të parandalohet çdo formë presioni për të zbuluar se për kë synojnë të votojnë zgjedhësit apo për kë kanë votuar. Asnjë lidhje midis zgjedhësit dhe një vote specifike nuk duhet të jetë e mundur.

Dy të tretat e qendrave të votimit të vëzhguara nuk lejuan akses të pavarur të zgjedhësve me aftësi të kufizuar, ndërsa sistemimi i mjedisit të brendshëm të qendrave të votimit nuk ishte i përshtatshëm për aksesin e tyre në 34 për qind të vëzhgimeve. Kjo nuk garanton plotësisht të drejtën e barabartë të votës për të gjithë zgjedhësit, siç kërkohet nga angazhimet e OSBE-së dhe detyrimet ndërkombëtare.¹⁰⁷

Për të garantuar të drejtë të barabartë vote për personat me aftësi të kufizuar, autoritetet duhet të marrin masa të vendosura për lehtësimin e pjesëmarrjes së pavarur të tyre në procedurat e votimit dhe të sigurojnë që mjediset dhe materialet të jenë të përshtatshme, të aksesueshme dhe të lehta për t'u përdorur.

B. MBYLLJA DHE NUMËRIMI

Procedura e mbylljes së qendrave të votimit u vlerësua negativisht në 17 për qind të vëzhgimeve. Disa procedura kyçe nuk u respektuan, përfshirë numërimin e nënshkrimeve të votuesve në listat e zgjedhësve (9 për qind) dhe të fletëve të votimit të papërdorura (10 për qind). Të kuptuarit e procedurave nga ana e komisionerëve u vlerësua negativisht në 10 për qind të rasteve.

Marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore në VNV u vlerësua pozitivisht; megjithatë, procesi u ndikua disa herë negativisht për shkak të mbipopullimit apo tensionit brenda VNV-ve.

Numërimi nuk filloi gjithmonë menjëherë pas marrjes në dorëzim të të gjitha materialeve zgjedhore nga qendrat e votimit, si dhe u bënë pushime, shpesh të zgjata, në 29 nga 59 VNV-të e vëzhguara, në kundërshtim me ligjin. Në disa raste, kjo erdhi për shkak se disa grupe numërimi ende po ngriheshin dhe trajtoheshin në natën e zgjedhjeve, gjë që thekson shqetësimin lidhur me mekanizmat e ngritjes së komisioneve të niveleve të ulëta. Atmosfera e përgjithshme në VNV gjatë numërimit u vlerësua, në përgjithësi, pozitivisht. Disa vlerësime negative erdhën në më të shumtën e rasteve si pasojë e mbipopullimit dhe tensionit brenda VNV-ve (20 për qind) dhe ndërhyrjes së paautorizuar në procesin e numërimit (13 për qind).

Pavarësisht nga vlerësimi përgjithësisht pozitiv i procesit të numërimit të votave, vëzhguesit e MNVZ-së raportuan parregullsi në procedura kyçe, gjë që solli një vlerësim negativ në 7 për qind të numërimeve të vëzhguara. Në 20 për qind të vëzhgimeve, fletët e votimit nuk u ekspozuan siç duhet para kamerave (të cilat e shfaqin fletën e votimit në një ekran të madh në VNV) për të treguar shenjë e bërë nga zgjedhësi dhe vulën në pjesën e pasme të fletës.

Verifikimi i përputhjes së numrit të fletëve të votimit të gjetura në kuti me numrin e nënshkrimeve të votuesve në listën e zgjedhësve është një element kyç i procesit të rakordimit. Megjithatë, dhe në kundërshtim me ligjin, ky verifikim nuk u krye në 13 për qind të numërimeve të vëzhguara.

¹⁰⁶ MNVZ-ja vëzhgoi raste të tilla në ZAZ-të 3, 11, 20, 22, 26, 27, 32, 36, 43, 44, 53, 54, 73 dhe 84.

¹⁰⁷ Neni 29(a) i CRPD-së i detyron Shtetet të "sigurojnë që personat me aftësi të kufizuar të mund të marrin pjesë në mënyrë të efektshme dhe të plotë në jetën politike dhe publike në baza të barabarta me të tjerët... duke siguruar, *ndër të tjera*, që procedurat, mjediset dhe materialet e votimit të jenë të duhura, të aksesueshme dhe të lehta... për t'u përdorur". Shih edhe paragrafin 7.3 të Dokumentit të Kopenhagenit të vitit 1990 dhe paragrafin 41.1 të Dokumentit të Moskës të vitit 1991.

Gjithashtu, formularët e tabelës së rezultateve të votimit dhe të mbylljes së qendrës së votimit nuk përmbajnë numrin e përgjithshëm të zgjedhësve të regjistruar. Sipas KQZ-së, kjo shifër gjendet në sistemin elektronik që transmeton rezultatet nga KZAZ-të te KQZ-ja dhe që kontrollon secilën tabelë të rezultateve për përputhshmëri.¹⁰⁸ Në përgjithësi, kjo praktikë e ul transparencën dhe i privon vëzhguesit nga mundësia për t'i vëzhguar në mënyrë të mirëfilltë procedurat e rakordimit.

Procesverbali i mbylljes së qendrës së votimit dhe tabelat e rezultatit të zgjedhjeve duhet të përmbajnë numrin e zgjedhësve të regjistruar në qendrën e votimit. Procedurat e rakordimit duhet të zbatohen me rreptësi gjatë numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultateve.

Vëzhguesve të partive iu mohua mundësia për të kontestuar fletët e votimit në 4 për qind të numërimeve të vëzhguara, dhe shkaqet për kontestimin e fletës të votimit nuk u regjistruan në këtë të fundit në 75 për qind të vëzhgimeve, siç kërkohet nga ligji. Në përgjithësi, shifrat në tabelat e rezultateve të zgjedhjeve rakordonin; megjithatë, në 16 për qind të vëzhgimeve, tabelat patën nevojë për korrigjime teknike.

Transparenca e procesit të numërimit ishte shpesh e kufizuar për shkak se vëzhguesit ishin të vendosur mjaft larg nga tryezat e numërimit dhe nuk kishin një pamje të qartë të procedurave të numërimit, gjë që u vërejt në 16 për qind të numërimeve të vëzhguara. Cilësia e dobët e pajisjeve të përdorura për projektimin e imazheve të fletëve të votimit në ekran e uli gjithashtu transparencën e procesit. Në 8 për qind të vëzhgimeve, vëzhguesit e partive nuk morën një kopje të tabelës së rezultatit të zgjedhjeve pasi e kërkuan. KQZ-ja filloi hedhjen e rezultateve paraprake në faqen e saj të internetit, sipas qendrave të votimit, në mëngjesin pas ditës së zgjedhjeve.

Planvendosja dhe sistemimi praktik i mjediseve të VNV-ve duhet të lejojnë që të gjithë vëzhguesit të ndjekin në mënyrë të mirëfilltë të gjitha aspektet e procedurave të numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve.

C. NXJERRJA DHE SHPALLJA E REZULTATEVE

Asnjë nga 90 KZAZ-të nuk i dorëzoi tabelat e rezultateve në KQZ brenda afatit ligjor të datës 26 qershor. Në 29 dhe 30 qershor, KQZ-ja u bëri thirrje 23 KZAZ-ve që kishin mbetur të dorëzonin materialet zgjedhore.¹⁰⁹ Për shkak të vonesave nga KZAZ-të, KQZ-ja nuk ishte në gjendje të miratonte rezultatet e zgjedhjeve sipas qarqeve deri më 5 korrik. Vonesat në procesin e nxjerrjes së rezultateve në KQZ erdhën gjithashtu si pasojë e kërkesave të disa partive politike të cilat i kërkuan KQZ-së të shtynte miratimin e rezultateve për disa qarqe deri sa partia në fjalë të kishte përfunduar verifikimin nga ana e saj të rezultatit të zgjedhjeve. Për shembull, në 30 qershor, gjatë mbledhjes së KQZ-së për miratimin e tabelës së rezultateve për qarkun e Fierit, përfaqësuesi i PD-së në KQZ kërkoi kopje të të gjitha tabelave të rezultateve të Fierit për verifikim të mëtejshëm. Për rrjedhojë, KQZ-ja e shtyu miratimin e këtyre rezultateve për në 3 korrik. Në të njëjtën linjë dhe për të njëjtën arsye, KQZ-ja pranoi kërkesën e PD-së në mbledhjen e datës 4 korrik për të shtyrë miratimin e tabelës së rezultateve për qarqet e Beratit dhe Vlorës. Megjithatë, KQZ-ja e rrëzoi kërkesën e PDIU-së për të shtyrë miratimin e tabelës së rezultateve për qarkun e Tiranës, gjë që tregoi qasjen shpesh selektive të KQZ-së në vendimmarrjen e saj.

Gjatë procesit të verifikimit dhe nxjerrjes së rezultatit, KQZ-ja korrigjoi 127 tabela të rezultateve të qendrave të votimit dhe 43 tabela përmbledhëse të rezultateve të KZAZ-ve, për arsye të ndryshme. Në disa raste, votat e regjistruara për një parti të caktuar në tabelat e rezultateve të qendrave të

¹⁰⁸ Në praktikë, gjatë numërimit, KZAZ-ja u jep grupeve të numërimit listën e qendrave të votimit dhe numrin përkatës të zgjedhësve të regjistruar.

¹⁰⁹ Shih deklaratat e KQZ-së të datave [29](#) dhe [30 qershor](#).

votimit ishin transferuar tek një parti tjetër në tabelën përmbledhëse të rezultateve të KZAZ-së.¹¹⁰ Në një rast, një KZAZ paraqiti një tabelë përmbledhëse rezultatesh ku mungonin të dhënat për disa qendra votimi.¹¹¹ Në raste të tjera, sipas KQZ-së, pjesa më e madhe e korrigjimeve në tabelat e rezultateve kishin natyrë teknike dhe nuk kërkonin rinumërim apo korrigjim të të dhënave të votave të vlefshme.

Në KQZ u ankuan tre vendime për miratimin e tabelave të rezultateve të qarqeve. PDIU-ja dhe PS-ja kundërshtuan rezultatin në Tiranë, ndërsa PD-ja bëri ankim ndaj rezultatit në Berat. Të tre ankimet u referoheshin parregullsive gjatë procesit të numërimit. PDIU-ja kërkoi rinumërim të votave për 41 qendra votimi, PS-ja kërkoi rinumërim për 23 qendra votimi dhe PD-ja për 4 të tjera. Këto kërkesa u pranuan dhe KQZ-ja rinumëroi votat për 68 qendra votimi në total në datat 13 dhe 14 korrik. Rinumërimi nuk nxori mospërputhje shifrash që të ndikonin në shpërndarjen e mandateve. Asnjë vendim i KQZ-së nuk u apelua në Kolegjin Zgjedhor pas zgjedhjeve.

Më 19 korrik, pas rinumërimave, KQZ-ja mori vendim për të kërkuar nisjen e procedimeve penale kundër 76 anëtarëve të grupeve të numërimit në Tiranë, bazuar në prova për falsifikim të rezultateve zgjedhore. Midis datave 12 dhe 20 korrik, KQZ-ja vendosi për shpërndarjen e mandateve për të gjitha qarqet. Asnjë vendim i KQZ-së nuk u apelua. Në 26 korrik, KQZ-ja shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve.

XV. REKOMANDIME

Këto rekomandime, ashtu siç janë paraqitur përgjatë gjithë raportit, ofrohen me synimin për të përmirësuar më tej zhvillimin e zgjedhjeve në Shqipëri dhe për të mbështetur përpjekjet për t'i sjellë ato plotësisht në përputhje me angazhimet e OSBE-së dhe me detyrimet dhe standardet e tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike. Këto rekomandime duhen lexuar së bashku me rekomandimet e mëparshme të OSBE/ODIHR-it, të cilat mbeten ende për t'u trajtuar. OSBE/ODIHR-i është i gatshëm t'i ndihmojë autoritetet shqiptare për të përmirësuar më tej procesin zgjedhor dhe për të trajtuar rekomandimet e përfshira në këtë raport dhe në raportet e mëparshme.¹¹²

A. REKOMANDIME PRIORITARE

1. Autoritetet duhet të ndërmarrin një reformë zgjedhore përfshirëse, të zhvilluar në kohë dhe të mbështetur në analiza të plota të politikave, me qëllim trajtimin e rekomandimeve të këtij raporti dhe raporteve të mëparshme të OSBE/ODIHR-it. Dispozitat në ligje të ndryshme që kanë të bëjnë me zgjedhjet duhet të harmonizohen, veçanërisht ato në lidhje me fushatën, financimin e fushatës dhe median.
2. Nevojiten përpjekje serioze për të trajtuar çështjen e vazhdueshme të blerjes së votës, si nëpërmjet një fushate për ndërgjegjësimin qytetar ashtu edhe nëpërmjet ndjekjes penale, me qëllim forcimin e besimit të procesit zgjedhor. Partitë politike mund të ndërmarrin një angazhim konkret dhe të

¹¹⁰ Për shembull, në ZAZ-të 29 dhe 30 (Tiranë), votat e regjistruara fillimisht për PD-në i ishin shtuar PR-së në tabelat përmbledhëse të rezultateve të ZAZ-së përkatesë. E njëjta situatë ndodhi edhe në ZAZ-të 64 e 66 në Berat. Në mënyrë të ngjashme, në të njëjtin qark, votat e regjistruara fillimisht për PDIU-në i ishin shtuar Partisë Demokratike Sociale. Një transferim i votave nga Partia e Unionit Demokristian Shqiptar te PD-ja u vërejt në ZAZ-në 12 (Lezhë), nga PR-ja te PD-ja në ZAZ-në 47 (Elbasan) dhe nga PDK-ja te PD-ja në ZAZ-në 54 (Fier). Në të gjitha këto raste, KQZ-ja i korrigjoi rezultatet në bazë të tabelave origjinale të rezultateve të votimit.

¹¹¹ KZAZ-ja 75 (Gjirokastrë) paraqiti në KQZ tabelën përmbledhëse të rezultateve në të cilën mungonin të dhënat për qendrat e votimit nr. 4146, 4148, 4156, 4166 dhe 4210.

¹¹² Në paragrafin 25 të Dokumentit të Stambollit të vitit 1999 të OSBE-së, Shtetet pjesëmarrëse angazhohen "të ndjekin menjëherë vlerësimet edhe rekomandimet e ODIHR-it për zgjedhjet".

mirëfilltë për të luftuar praktikën e blerjes së votës. Gjithashtu, një refuzim publik nga ana e politikanëve për të pranuar mbështetje financiare nga individë me të kaluar kriminale do të ndihmonte në ndërtimin e besimit të publikut në integritetin e zgjedhjeve.

3. Qeveria duhet të analizojë efektshmërinë e përpjekjeve të mëparshme për të luftuar shpërdorimin e burimeve shtetërore dhe presionet e lidhura me vendin e punës mbi zgjedhësit. Ajo duhet të marrë në konsideratë ngritjen e një organi transparent, të pavarur dhe përfshirës me detyrën dhe kompetencën e veprimit dhe të ndjekjes nëse vihet në dijeni për çështje të tilla në periudhën para dhe paszgjedhore. Kjo strukturë mund të ngrihet edhe në nivel vendor në një kohë të mjaftueshme përpara zgjedhjeve të radhës.
4. Ligji mund të ndryshohet për të lejuar emërimin mbi baza jopartiake të komisionerëve zgjedhorë dhe anëtarëve të grupeve të numërimit. Kodi Zgjedhor duhet të ndryshohet për të ndaluar zëvendësimin diskrecional të anëtarëve të KZAZ-ve nga ana e partive propozuese. Gjithashtu, duhet t'i kushtohet vëmendje mundësisë së vendosjes së mekanizmave alternativë për emërimin e anëtarëve të KQV-ve dhe të grupeve të numërimit në rast se partitë politike nuk propozojnë emra.
5. Kufizimet e së drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuar mendore duhet të hiqen. Duhet të ndërpritet heqja automatikisht e zgjedhësve të moshës 100 vjeç apo më shumë nga listat e zgjedhësve, dhe detyrimi për të verifikuar të dhënat e këtyre zgjedhësve duhet të vendoset mbi shtetin.
6. Dispozitat penale për shpifjen duhet të shfuqizohen duke u dhënë përparësi zgjedhjeve juridike civile të hartuara për të rivendosur në vend reputacionin e dëmtuar.
7. Për të forcuar transparencën, ligji duhet të garantojë të drejta të njëjta për të gjithë vëzhguesit dhe të përcaktojë qartë se të gjithë vëzhguesit kanë të drejtë të marrin kopje të tabelës së rezultateve.
8. Shteti duhet të garantojë të drejtën për të bërë një zgjedhje të lirë dhe të fshehtë. Duhet të parandalohet çdo formë presioni për të zbuluar se për kë synojnë të votojnë zgjedhësit apo për kë kanë votuar. Asnjë lidhje midis zgjedhësit dhe një vote specifike nuk duhet të jetë e mundur.

B. REKOMANDIME TË TJERA

Administrata Zgjedhore

9. Për të forcuar kapacitetet profesionale të komisioneve zgjedhore, KQZ-ja mund të ofrojë rregullisht trajnime me certifikim për anëtarë të mundshëm të KZAZ-ve, KQV-ve dhe grupeve të numërimit, dhe të krijojë një regjistër me personat e certifikuar.
10. Duhet të bëjë përpjekje për nxitjen e përfaqësimit të baraspeshuar gjinor në të gjitha nivelet e administratës zgjedhore, përfshirë pozicionet vendimmarëse.
11. Për të siguruar zbatim të njëtrajtshëm të rregullave dhe trajtim të barabartë të zgjedhësve, ndryshimet në rregullat e votimit nuk duhet të bëhen ditën e zgjedhjeve, përveç se në rastet e një force madhore.

Regjistrimi i Zgjedhësve

12. Duhet intensifikuar përpjekjet për të siguruar saktësinë e të dhënave për të gjithë zgjedhësit, përfshirë caktimin e kodeve të sakta të adresave dhe zgjidhjen e çështjes së të dhënave të shumëfishta. Duhet krijuar gjithashtu një sistem i efektshëm i shpërndarjes së njoftimit të zgjedhësve që të sigurojë informimin e tyre në kohë se ku mund të verifikojnë të dhënat në listën e zgjedhësve dhe vendndodhjen e qendrës së tyre të votimit.

Regjistrimi i Kandidatëve

13. Për të forcuar më tej transparencën dhe besimin në proces, duhet t'i kushtohet vëmendje dhënies së mundësisë aktorëve zgjedhorë për të vëzhguar drejtpërdrejt verifikimin e nënshkrimeve mbështetëse të kandidatëve. Procesi duhet të përkufizohet qartë dhe të përfshijë hapat që duhet të ndiqen në rast se ka ankime.

14. Mund t'i kushtohet vëmendje forcimit të masave të posaçme ekzistuese për rritjen e pjesëmarrjes politike të grave, në përputhje me standardet ndërkombëtare. Kjo mund të përfshijë detyrimin për alternimin e kandidatëve burra dhe gra në lista, si dhe parashikimin dhe zbatimin e sanksioneve të efektshme dhe proporcionale, përfshirë mosregjistrimin e listave, për mosrespektim të këtyre masave.

Fushata Zgjedhore

15. Autoritetet dhe partitë politike duhet të konsiderojnë marrjen e hapave më të vendosura për të siguruar që të mos ushtrohet presion mbi punonjësit e sektorit publik, aktivistët politikë dhe qytetarët e tjerë për të marrë pjesë në aktivitete të fushatës apo për të votuar në një mënyrë të caktuar. Çdo rast dhe pretendim për presion duhet të hetohet dhe ndiqet në mënyrë tërësore dhe të efektshme nga autoritetet përkatëse. Të gjitha rastet, përfshirë rezultatit e tyre, duhet të raportohen publikisht.

Financimi i Fushatës

16. Duhet të harmonizohen rregullat për financimin e fushatës dhe duhet të hartohen akte nënligjore me qëllim që të sigurohet një metodologji solide dhe qasje në informacionin e plotë mbi financimin e fushatës për ekspertët financiarë dhe zgjedhësit para dhe pas ditës së zgjedhjeve. Mund t'i kushtohet vëmendje përcaktimit të afateve për përfundimin e auditimeve paszgjedhore.

Media

17. Për të siguruar pavarësi editoriale të medias, duhet konsideruar shfuqizimi i nenit 84.1 të Kodit Zgjedhor dhe ndalimi në mënyrë të qartë i transmetimit në lajme të reklamave politike.

Pjesëmarrja e Pakicave Kombëtare

18. KQZ-ja dhe aktorë të tjerë mund të organizojnë programe edhe më përfshirëse për edukimin e zgjedhësve në nivel personal të përshtatura sipas nevojave të pakicave kombëtare Rome dhe Egjiptiane.

Ankimet dhe Apelimet

19. Ligji duhet të përcaktojë qartë përgjegjësitë për ankimet përpara ditës së zgjedhjeve, sipas objektit të tyre të kërkesës, me qëllim që të sigurohet zgjidhje efektive. Procedurat e ankimit mund të thjeshtohen dhe afatet për zgjidhjen e ankimeve mund të shkurtohen.

20. Partive politike dhe zgjedhësve të cilëve u preken drejtpërdrejt të drejtat apo interesat nga akte të administratës zgjedhore duhet t'u njihet legjitimimi për t'i apeluar këto akte në një organ gjyqësor. Afatet ligjore për shqyrtimin e apelimit mund të shkurtohen.

Dita e Zgjedhjeve

21. Për të garantuar të drejtë të barabartë vote për personat me aftësi të kufizuar, autoritetet duhet të marrin masa të vendosura për lehtësimin e pjesëmarrjes së pavarur të tyre në procedurat e votimit dhe të sigurojnë që mjediset dhe materialet të jenë të përshtatshme, të aksesueshme dhe të lehta për t'u përdorur.

22. Procesverbali i mbylljes së qendrës së votimit dhe tabelat e rezultatit të zgjedhjeve duhet të përmbajnë numrin e zgjedhësve të regjistruar në qendrën e votimit. Procedurat e rakordimit duhet të zbatohen me rreptësi gjatë numërimit të votave dhe nxjerrjes së rezultateve.

23. Planvendosja dhe sistemimi praktik i mjediseve të VNV-ve duhet të lejojnë që të gjithë vëzhguesit të ndjekin në mënyrë të mirëfilltë të gjitha aspektet e procedurave të numërimit dhe nxjerrjes së rezultateve.

SHTOJCA I: REZULTATET PËRFUNDIMTARE TË ZGJEDHJEVE ¹¹³

	Partia politike	Votat	Përqindja	Mandatet
1	Lëvizja Socialiste për Integrim	225,901	14,20	19
2	Partia Socialiste e Shqipërisë	764,750	48,30	74
3	Partia Kristian Demokrate	2,421	0.15	0
4	Sfida për Shqipërinë	3,546	0.22	0
5	Partia Republikane e Shqipërisë	3,225	0.20	0
6	Partia Demokratike	456,413	28.80	43
7	Partia Bashkimi Demokristian Shqiptar	924	0.06	0
8	Partia Aleanca Demokristiane	767	0.05	0
9	Partia Social Demokrate	14,993	0.95	1
10	Aleanca Demokratike	547	0.03	0
11	Fryma e Re Demokratike	5,146	0.33	0
12	Partia Demokracia Sociale	2,473	0.16	0
13	Partia për Drejtësi, Integrim dhe Unitet	76,069	4.81	3
14	Aleanca <i>Arbnore</i>	351	0.02	0
15	Minoriteti Etnik Grek për të Ardhmen	2,287	0.14	0
16	Partia Komuniste e Shqipërisë	1,026	0.06	0
17	Aleanca Popullore për Drejtësi	1,505	0.10	0
18	Lista e Barabartë	19,806	1.25	0
	Gjithsej	1,582,150	100	140

Numri gjithsej i zgjedhësve në listat e zgjedhësve	3,452,324
Numri i zgjedhësve që votuan	1,613,789 (46.7%)
Numri i votave të vlefshme të hedhura në kuti	1,582,150
Numri i votave të pavlefshme të hedhura në kuti	31,639 (2%)

¹¹³ Burimi: [Vendimi i KQZ-së 26 korrik 2017](#).

SHTOJCA II: LISTA E VËZHguesVE TË MISIONIT NDËRKOMBËTAR TË VËZHGIMIT TË ZGJEDHJEVE

Asambleja Parlamentare e OSBE-së

Roberto Battelli	Koordinator i Posaçëm	Slloveni	
Marietta Tidei	Kryetare e Delegacionit	Itali	
Michael Hammer	Deputet	Austri	
Vincent Van Quickenborne	Deputet	Belgjikë	
Ladislav Šinčl	Deputet	Republika Çeke	
Kuelliki Kubarsepp	Deputet	Estoni	
Mart Nutt	Deputet	Estoni	
George Tsereteli	Deputet	Gjeorgji	
Juergen Willi Klimke	Deputet	Gjermani	
Christos Dimas	Deputet	Greqi	
Anastasia Gkara	Deputet	Greqi	
Maria Theleriti	Deputet	Greqi	
Luigi Compagna	Deputet	Itali	
Sergio Divina	Deputet	Itali	
Federico Fauttilli	Deputet	Itali	
Barbara Bartus	Deputet	Poloni	
Grzegorz Schreiber	Deputet	Poloni	
Jacek Wlosowicz	Deputet	Poloni	
Peter Osusky	Deputet	Sllovaki	
Laura Castel	Deputet	Spanjë	
Ignacio Sanchez Amor	Deputet	Spanjë	
Margareta Cederfelt	Deputet	Suedi	
Ola Johansson	Deputet	Suedi	
Sven-Olof Sallstrom	Deputet	Suedi	
Margareta Kiener Nellen	Deputet	Zvicër	
Silvia Demir	Personel i Delegacionit	Republika Çeke	
Georgios Champouris	Personel i Delegacionit	Greqi	
Giuseppe Trezza	Personel i Delegacionit	Itali	
Andreas Nothelle	Sekretariati i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së	Gjermani	
Tim Knoblaue	Sekretariati i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së	Gjermani	
Roberto Montella	Sekretariati i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së	Itali	
Francesco Pagani	Sekretariati i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së	Itali	
Anna Di Domenico	Sekretariati i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së	Itali	
Nathaniel Parry	Sekretariati i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së	Shtetet e Bashkuara të Amerikës	

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës

Paolo Corsini	Kryetar i Delegacionit	Itali
Stefan Schennach	Deputet	Austri
Miroslav Nenutil	Deputet	Republika Çeke
Attila Tilki	Deputet	Hungari
Joseph O'Reilly	Deputet	Irlandë
Andrea Rigoni	Deputet	Itali
Luis Alberto Orellana	Deputet	Itali
Joseph Debono-Grech	Deputet	Maltë
Predrag Sekulić	Deputet	Mali i Zi

Reina De Bruijn-Wezeman	Deputet	Holandë
Mart van De Ven	Deputet	Holandë
Ingebjørg Godskesen	Deputet	Norvegji
Jaroslav Obremski	Deputet	Poloni
Idália Serrão	Deputet	Portugali
Ionut-Marian Stroe	Deputet	Rumani
Marco Nicolini	Deputet	San Marino
Jan Škoberne	Deputet	Slloveni
Fernando Maura	Deputet	Spanjë
Serhii Kiral	Deputet	Ukrainë
Radek Merkl	Personel i Delegacionit	Republika Çeke
Nikolai Vulchanov	Komisioni i Venecias	Bullgari
Mesut Bedirhanoglu	Komisioni i Venecias	Fancë
Franck Daeschler	Sekretariati i PACE-s	Fancë
Bogdan Torcătoriu	Sekretariati i PACE-s	Rumani
Anne Godfrey	Sekretariati i PACE-s	Mbretëria e Bashkuar

Parlamenti Evropian

Eduard Kukan	Kryetar i Delegacionit	Sllovaki
Angel Dzhambazki	Deputet i PE-së	Bullgari
Tamás Meszerics	Deputet i PE-së	Hungari
Elena Schlein	Deputet i PE-së	Itali
Frank Engel	Deputet i PE-së	Luksemburg
Ryszard Czarnecki	Deputet i PE-së	Poloni
Cristian Dan Preda	Deputet i PE-së	Rumani
Julianna Huszár-Dékany	Sekretariati i PE-së	Hungari
Aušra Rakštelytė	Sekretariati i PE-së	Lituani
Andrés Montoya Lozano	Sekretariati i PE-së	Spanjë
Tim Boden	Sekretariati i PE-së	Mbretëria e Bashkuar

Vëzhguesit afatshkurtër të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it

Norbert Baldia	Austri
Theresa Baumann	Austri
Florian Doschek	Austri
Katharina Enzesberger	Austri
Meinrad Hofer	Austri
Martin Kraemer	Austri
Iris O'Rourke	Austri
Jean-Pierre Biebuyck	Belgjikë
Terezina Dajlani	Belgjikë
Karen De Dycker	Belgjikë
Ndini Ermal	Belgjikë
Yannick Ghelen	Belgjikë
Goffroy Kensier	Belgjikë
Cédric Schampers	Belgjikë
Radi Ignatov	Bullgari
Dimitrina Temelkova	Bullgari
Petra Mijic	Kroaci
Olga Blatakova	Republika Çeke
Sarka Havrankova	Republika Çeke

Radek Hovorka	Republika Çeke
Karel Kovanda	Republika Çeke
Marianka Mackova	Republika Çeke
Marketa Nekvindova	Republika Çeke
Martin Ocknecht	Republika Çeke
Martin Svarovsky	Republika Çeke
Zaneta Vencourova	Republika Çeke
Jana Zavodnikova	Republika Çeke
Christian Wolter Andersen	Danimarkë
Jonas Skovrup Christensen	Danimarkë
Bo Gullack Flindt	Danimarkë
Ellen Buch-Hansen	Danimarkë
Peter Hellmers	Danimarkë
Bo Jensen	Danimarkë
Kim Benedikt Johnsen	Danimarkë
Jytte Vagner Petersen	Danimarkë
Sofia Katrine Svensson	Danimarkë
Lilian Pallum	Estoni
Sally Ida Anastasia Asikainen	Finlandë
Jyrki Matti Kankaanpää	Finlandë
Petteri Londen	Finlandë
Anja Paajanen	Finlandë
Tarja Raappana	Finlandë
Christian Wallin	Finlandë
Alexandre Balguy-Gallois	Fancë
Jessica Berthereau	Fancë
Marie-Florence Bennes	Fancë
Marie Bertrand	Fancë
Melissa Diagne	Fancë
Magali Doisy	Fancë
Léa Drouet	Fancë
Kilian Hocquart	Fancë
Thomas Delic Isabelle	Fancë
Guillaume Javourez	Fancë
Augustin Laborde	Fancë
Laurent Lemarchand	Fancë
Mounia Malki	Fancë
Antoine Meyer	Fancë
Eric Mirguet	Fancë
Sabine Ohayon	Fancë
Paul Ruotte	Fancë
Claudio Serafini	Fancë
Claire Schmitt	Fancë
Christina Vazak	Fancë
Anne-Sophie Veyrier	Fancë
Rolf Boehnke	Gjermani
Edgar Brueser	Gjermani
Michael Cemerin	Gjermani
Gerda Elisabeth Charlotte Dopheide	Gjermani
Matthias Dornfeldt	Gjermani
Janna Greve	Gjermani
Sabine Häußler	Gjermani

Maria Mechthild Herkenhoff	Gjermani
Katharina Hötger	Gjermani
Tom Sobjerg Hoyem	Gjermani
Christiane Jaenicke	Gjermani
Maren Kneller	Gjermani
Christian Peter Lames	Gjermani
Janina Markewitsch	Gjermani
Martin Mayer	Gjermani
Edith Maria Mueller	Gjermani
Kirsten Katrin Mueller	Gjermani
Jana Sophia Nolle	Gjermani
Detlev Palluch	Gjermani
Faik Yanki Pürsün	Gjermani
Norbert Hermann Reiner	Gjermani
Karen Knipp-Rentrop	Gjermani
Iris Rotzoll	Gjermani
Ilona Salaba	Gjermani
Johannes Schmid	Gjermani
Sabine Smolka-Gunsam	Gjermani
Hubert Strobel	Gjermani
Nicola Schmidt	Gjermani
Beatrice Tschinkel	Gjermani
Matthias Zeller	Gjermani
Konstantinos Kyriou	Greqi
Pagona Larda	Greqi
Antonios Papamalis	Greqi
Simella Tsaloukidou	Greqi
Áron Albert	Hungari
Zsuzsanna Baracsi	Hungari
László Horváth	Hungari
Iván Kovács	Hungari
Elza Schönstein	Hungari
Emese Siroki	Hungari
Michael Charles Good	Irlandë
Tjörvi Einarsson	Islandë
Stefanía Traustadóttir	Islandë
Gabrielle Brocklesby	Irlandë
Kevin Grogan	Irlandë
Raymond Charles Maxwell	Irlandë
Robert Mc Daid	Irlandë
Almha Caitriona O'Keefe	Irlandë
Daniele Aloisi	Itali
Giacomo Antonio Pides	Itali
Francesca Chessa	Itali
Walter Citti	Itali
Elena Ferrero	Itali
Dario Intini	Itali
Elsa Pacella	Itali
Carlo Pappalardo Fischer	Itali
Yosuke Sekiguchi	Japoni
Taro Tsukimura	Japoni
Dana Tjurina	Letoni

Sebastian Aloysius Fredericus Berends	Holandë
Vanesa Berisha	Holandë
Olga Annuska Heldring	Holandë
Eelco Keij	Holandë
Johanna Sophia Allegonda Marie Schokkenbroek	Holandë
Johannes Van Oort	Holandë
Apolonia Verschoor	Holandë
Beata Katarzyna Szczypka Elyachouti	Norvegji
Lars Georg Fordal	Norvegji
Betu Kajigi	Norvegji
Marie Osnes	Norvegji
Ciprian Alionescu	Rumani
Ramona -Maria Ciuca	Rumani
Mihai Constantinescu	Rumani
Oana-Catalina Ichim	Rumani
Viacheslav Pimenov	Federata Ruse
Anna Rykova	Federata Ruse
Martin Balco	Sllovaki
Slavomír Kantor	Sllovaki
Roman Krištofik	Sllovaki
Darinka Bogdanovic	Slloveni
Milagros Crespo Casado	Spanjë
Manuel Iglesias Cavicchioli	Spanjë
Amparo Hormigos Fernández	Spanjë
Jose Alberto Quero Moreno	Spanjë
Augusto Delkáder Palacios	Spanjë
José Luis Pellicer	Spanjë
Lucia Ferreiro Prado	Spanjë
Ana Elvira Fernández-Tresguerres	Spanjë
Sara-Sofia Agnemo	Suedi
Linda Cederblad	Suedi
Nicolas Heyum	Suedi
Evy Birgitta Jansson	Suedi
Jenny Elisabeth Renée Nordman	Suedi
Eva Rimsten	Suedi
Preben Rydin	Suedi
Ann-Sofie Sten	Suedi
Bjorn Mikael Tedeman	Suedi
Johanna Van Rooij	Suedi
Karin Wenander	Suedi
Anna Widmark	Suedi
Cecilia Hull Wiklund	Suedi
Daniele D'Esposito	Zvicër
Roman Enzler	Zvicër
Tobias Sebastian Gessler	Zvicër
Josef Christoph Graf	Zvicër
Aysun Inceleme	Zvicër
Daliborka Jankovic	Zvicër
Francine John	Zvicër
Fritz Krebs	Zvicër
Adina Segura Loza	Zvicër
Sandro Schmidlin	Zvicër

Kebiana Doci	Mbretëria e Bashkuar
Paul Francis Edmunton	Mbretëria e Bashkuar
Edward John Francis Vigilius Melotte	Mbretëria e Bashkuar
Moshtayeen Ahmad	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Ethan Arnheim	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Jacqueline Beaudry	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Alma Begicevic	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Klara Bilgin	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Laura Bowman	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Suanne Buggy	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Keara Castaldo	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Donal Doyle	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
William Hanlon	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Neil Glick	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
John Herring	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Crawford Ian	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Jeffrey Jacobs	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Constance Kaplan	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Miyuki Kawai	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Dwayne King	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Genevra Kingsley	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Neil Kornze	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Mark Lasser	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Lia Lockert	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
William Luhrs	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Kevin Mclaughlin	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Alida (Peachy) Melancon	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Charles Melancon	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Megan Niedermeyer	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Ruby Norfolk	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Kathy Parkison	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Urania Petit	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Azita Ranjbar	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Arthur Traldi	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Douglas Tremitiere	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Ernest Eugene Wickersham	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Vëzhguesit afatgjatë

Ekipi bazë i MVZ-së së OSBE/ODIHR-it

Peter Tejler	Kryetar i Misionit	Suedi
Wolfgang Sporrer		Austri
Vasil Vashchanka		Bjellorusi
Vedrana Halilović		Kroaci
Monica Moravcová		Republika Çeke
Kakha Inaishvili		Gjeorgji
Lela Tsaava		Gjeorgji
László Belágyi		Hungari
Andrea Malnati		Itali
Maria Krause		Rumani

Ranko Vukčević	Serbi
Robert Bystricky	Slllovakia
Anders Eriksson	Suedi
Polyna Lemos	Mbretëria e Bashkuar
William Romans	Mbretëria e Bashkuar

Vëzhguesit afatgjatë të MVZ-së së OSBE/ODIHR-it

Ramin Nuraliyev	Azerbajxhan
Aleš Jakubec	Republika Çeke
Milan Kuksa	Republika Çeke
Niels Boel	Danimarkë
Katerina Koceva	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë
Maylis De Verneuil	Fancë
Laura Kalfon	Fancë
Jehodit ThamarOrland	Gjermani
Michael Ickes	Gjermani
John Ignatius Burke	Irlandë
Daniela Bottigelli	Itali
Alessandro Giongo	Itali
Munkhnaran Bayarlkhagva	Mongoli
Bojana Živković	Mali i Zi
Laurens Joseph Teule	Holandë
Daan Willem	Holandë
Per Oeyvind Semb	Norvegji
Luminita Balan	Rumani
Nenad Čelarević	Serbi
Bjoern Erik Lundqvist	Suedi
Lars Tore Tollemark	Suedi
Andreas Martin Speiser	Zvicër
Monica Angela Giambonini	Zvicër
Cara Stern	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
William Spitznagle	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
Andral Bratton	Shtetet e Bashkuara të Amerikës

RRETH OSBE/ODIHR-it

Zyra për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (OSBE/ODIHR) është institucioni kryesor i OSBE-së që ndihmon Shtetet pjesëmarrëse “të sigurojnë respektim të plotë të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, të respektojnë shtetin e së drejtës, të promovojnë parimet e demokracisë dhe (...) të ndërtojnë, të forcojnë dhe të mbrojnë institucionet demokratike, si dhe të nxisin tolerancën në të gjitha nivelet e shoqërisë” (Dokumenti i Samitit të Helsinkit 1992). Kjo pjesë referohet edhe si dimensionin njerëzor i OSBE-së.

OSBE/ODIHR-i, me seli në Varshavë (Poloni), u krijua si Zyra për Zgjedhje të Lira, në Samitin e Parisit në vitin 1990, dhe filloi funksionimin në maj të vitit 1991. Një vit më vonë, emri i Zyrës u ndryshua për të pasqyruar një mandat më të zgjeruar, ku të përfshiheshin të drejtat e njeriut dhe demokratizimi. Sot, organizata punëson mbi 150 vetë.

OSBE/ODIHR-i është agjencia paraprijëse në Evropë në fushën e **vëzhgimit të zgjedhjeve**. Çdo vit, ai bashkërendon dhe organizon dërgimin e mijëra vëzhguesve për të vlerësuar zgjedhjet në rajonin e OSBE-së, nëse ato janë në përputhje me angazhimet e OSBE-së, standarde të tjera ndërkombëtare për zgjedhje demokratike, si dhe me legjislacionin vendas. Metodologjia unike siguron një vështrim në thellësi të të gjithë elementëve të procesit zgjedhor. Me anë të projekteve të asistencës, OSBE/ODIHR-i i ndihmon Shtetet pjesëmarrëse të përmirësojnë kuadrin e tyre zgjedhor.

Veprimtaritë e Zyrës për **demokratizimin** përfshijnë: shtetin e së drejtës, mbështetjen legjislative, qeverisjen demokratike, migracionin dhe lirinë e lëvizjes, si edhe barazinë gjinore. OSBE/ODIHR-i zbaton disa programe asistence të fokusuar, çdo vit, për zhvillimin e strukturave demokratike.

Po ashtu, OSBE/ODIHR-i ndihmon Shtetet pjesëmarrëse në përmbushjen e detyrimeve të tyre për promovimin dhe mbrojtjen e **të drejtave të njeriut dhe lirive themelore** në përputhje me angazhimet e OSBE-së për dimensionin njerëzor. Kjo arrihet duke punuar me një sërë partnerësh me qëllim nxitjen e bashkëpunimit, krijimin e kapaciteteve dhe ofrimin e ekspertizës në fusha tematike, përfshirë të drejtat e njeriut në luftën kundër terrorizmit, forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut për personat e trafikuar, edukimin dhe trajnimin për të drejtat e njeriut, monitorimin dhe raportimin mbi të drejtave të njeriut, si dhe garantimin e të drejtave dhe sigurisë së grave.

Në kuadrin e **tolerancës** dhe **mosdiskriminimit**, OSBE/ODIHR-i i jep mbështetje Shteteve pjesëmarrëse për të forcuar përgjigjet e tyre ndaj krimeve të urrejtjes dhe incidenteve të racizmit, ksenofobisë, antisemitizmit dhe formave të tjera të intolerancës. Veprimtaritë e OSBE/ODIHR-it në lidhje me tolerance dhe mosdiskriminimin përqendrohen te: legjislacioni, trajnimi në drejtim të zbatimit të ligjeve, monitorimi, raportimi dhe ndjekja e përgjigjeve që u jepet krimeve dhe incidenteve të motivuara nga urrejtja, si edhe aktivitete edukative për të nxitur tolerancën, respektin dhe mirëkuptimin e ndërsjellë.

OSBE/ODIHR-i i këshillon Shtetet pjesëmarrëse mbi politikat e tyre për komunitetet **Rome dhe Sinti**. Ai nxit ngritjen e kapaciteteve dhe lidhjet mes komuniteteve rome dhe sinti, si dhe inkurajon pjesëmarrjen e përfaqësuesve romë dhe sinti në organet politikëbërëse.

Të gjitha veprimtaritë e ODIHR-it zhvillohen në bashkëpunim dhe bashkërendim të ngushtë me Shtetet pjesëmarrëse në OSBE, institucionet dhe përfaqësitë në terren të OSBE-së, si dhe me organizata të tjera ndërkombëtare.

Informacione të mëtejshme mund të gjeni në faqen e internetit të ODIHR-it (www.osce.org/odihr).